



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.65

31 maj

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.322, datë 5.5.2010

Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet
Elektronike në Republikën e Shqipërisë 2465

VENDIM
Nr.322, datë 5.5.2010

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PËR KOMUNIKIMET
ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 pika 1 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit të bashkëpunojë me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe institucionet e tjera për ndjekjen dhe zbatimin e planveprimeve, që i bashkëlidhet këtij dokumenti.

3. Ngarkohet Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi nr.288, datë 18.6.1999 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit të politikave për zhvillimin e telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DOKUMENTI I POLITIKAVE PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

PARATHËNIE

Ky dokument i politikave përcakton strategjinë afatmesme të Qeverisë për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ky dokument do të zëvendësojë dokumentin e politikave për sektorin e telekomunikacioneve të miratuar në vitin 1999. Termi komunikime elektronike është i ri (i miratuar nga BE-ja në vitin 2002) dhe përfshin të gjitha llojet e komunikimeve elektronike, telekomunikacionet, transmetimin e të dhënave dhe transmetimet televizive ,të cilat do të mbarten nga rrjete të njëjta.

Politika është në përputhje me “Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2007-2013”¹ dhe në përputhje me traktatin dhe marrëdhëniet politike të Shqipërisë me BE-në, synon integrimin në tregun e përbashkët të komunikimeve elektronike të BE-së.

Ky dokument rishikon situatën aktuale në tregun shqiptar të komunikimeve elektronike, duke konsideruar kontekstin politik, organizimin institucional të krijuar nga ligji aktual dhe zhvillimet e mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, konsideron nevojën për të përshtatur këtë organizim si shkak i konvergjencës ndërmjet transmetimit dhe komunikimeve private. Ky dokument paraqet vizionin e Qeverisë për zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike në të ardhmen në kontekst të planeve përkatëse kombëtare, si dhe vendos objektivat për tema të caktuara të rëndësishme,ku është i nevojshëm veprimi ose ku udhëzimet nga institucionet shtetërore do të ishin të nevojshme.

¹ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, <http://www.keshilliministrave.al/?fq=brenda&r=&gj=gj1&kid=71>

Lista e veprimeve për vitin 2010 dhe 2011 është pjesë e veçantë e këtij dokumenti. Kjo listë ka një perspektivë afatshkurtër në krahasim me tekstin kryesor të politikave, prandaj edhe mund të përditësohet në mënyrë periodike.

Ky dokument i politikave, gjithashtu merr në konsideratë përgjigjet e këshillimit publik të zhvilluar në gjysmën e dytë të vitit 2009.

I. HYRJE

KAPITULLI 1 BAZA DHE KUADRI LIGJOR

Qëllimi i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike” është të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturën efikase nëpërmjet parimit të neutralitetit të teknologjisë së komunikimeve elektronike dhe të sigurojë shërbimet e duhura në territorin e Republikës së Shqipërisë. Suksesi i këtij ligji do të vlerësohet nëpërmjet shërbimeve cilësore të ofruara në raport me çmimet.

1.1 Baza ligjore

Baza ligjore e këtij dokumenti të politikave është ligji nr. 9918. Neni 5 i jep ministrit përgjegjës për sektorin e shërbimeve² të komunikimeve elektronike kompetenca për të përgatitur dokumentin e politikave për komunikimet elektronike për miratim nga Këshilli i Ministrave.

Duke u mbështetur në përcaktimet në nenin 138 të ligjit nr. 9918, vendimet e mëparshme të Këshillit të Ministrave³ do të mbesin në fuqi deri sa të shfuqizohen ose zëvendësohen. Prandaj, të gjitha dokumentet e mëparshme do të anulohen kur të jetë miratuar ky dokument.

Qëllimi i ligjit nr.9918 është t'i paraprijë liberalizimit të shërbimeve të sektorit të komunikimeve elektronike në dobi të qytetarëve shqiptarë dhe kjo të bëhet në përputhje me detyrimet e Shqipërisë⁴ sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së dhe detyrimet e saj ndaj OBT sipas shtojcës për telekomunikacionet të GATS.

1.2 Baza ekonomike dhe politikat

Ambicia afatmesme ekonomike e Shqipërisë, siç është paraqitur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013⁵ dhe nëpërmjet marrëdhënieve politike me BE-në, është të arrihet integrimi në tregun e përbashkët të BE-së. Kjo ambicie përfshin konvergjencën e nivelit ekonomik të Shqipërisë me mesataren e BE-së. Ky qëllim ka disa pasoja, për shembull: për rritjen ekonomike, për nivelet e investimit, për rritjen e prodhimit, për tregtinë, për disponueshmërinë e shërbimeve moderne dhe për disponueshmërinë e subvencioneve të BE-së. Si vendet e tjera të cilat e kanë përmirësuar situatën e tyre ekonomike brenda tregut të përbashkët të BE-së, ekonomia shqiptare do të duhet të prodhojë pasurinë e nevojshme për të mbështetur këto qëllime. Megjithatë, ritmi i konvergjencës ekonomike do të rritet nëse Shqipëria mbetet një importues neto i kapitalit për disa dekada. Promovimi i investimeve të jashtme brenda Shqipërisë është një aspekt kyç i menaxhimit të ekonomisë.

Janë një numër faktorësh të rëndësishëm të cilët kontribuojnë në suksesin e një vendi për tërheqjen e investimeve të jashtme. Elementi kryesor është të sigurohen investitorët që investimet e tyre do të jenë të sigurta dhe do të nxjerrin fitime të mjaftueshme. Ndoshta faktori më i rëndësishëm

2 Aktualisht është Ministri i Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

3 VKM nr. 288 ,datë 18.6.1999 "Për miratimin e dokumentit të politikave"

VKM nr. 311 ,datë 5.7.1999 "Mbi një shtesë në dokumentin e politikave"

VKM nr. 615, datë 2.11.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime në dokumentin e politikave"

VKM nr. 692, datë 27.12.2002 "Mbi disa shtesa në dokumentin e politikave"

VKM nr. 464 ,datë 3.7.2003 "Mbi ndryshimet në dokumentin e politikave"

4 Nenet 70 dhe 71 i MSA

5 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, shih: <http://www.km.gov.al/?fq=brenda&r=&gj=gj1&kid=71>

është reputacioni i vendit dhe historia e trajtimit të drejtë të investitorëve të huaj. Kjo është e lidhur me efikasitetin e administratës publike dhe gjykatave si dhe me besueshmërinë e veprimeve të qeverisë . Faktori i dytë, është stabiliteti politik. Nëse rreziku konsiderohet i lartë, investitorët do të kërkojnë tarifa më të larta dhe si rezultat konsumatorët do të paguajnë çmime më të larta. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, perspektiva për anëtarësim në BE dhe vazhdueshmëria e progresit në këtë drejtim janë faktorë të rëndësishëm që i ofrojnë siguri investitorëve të huaj dhe i drejtojnë ata për të pranuar norma normale të kthimit

Për sektorin e komunikimeve elektronike në veçanti, investimet janë të pakta, të mëdha dhe relativisht afatgjatë. Për të siguruar investitorët dhe për të zvogëluar rrezikun e perceptuar në këtë sektor, faktorë të tjerë të rëndësishëm janë profesionalizmi dhe pavarësia e organeve⁶ të rëndësishme rregullore dhe cilësisë dhe zbatimit të regjimit rregullator. Këto faktorë janë të studiuara me kujdes dhe raportohen në të gjitha vendet e botës, prandaj shumica e investitorëve mund të informohen lehtësisht lidhur me cilësinë dhe vazhdimësinë e vendimeve. Megjithatë, për investitorët nuk është e mjaftueshme nëse institucionet shqiptare janë të suksesshme sot, ata duhet të jenë të sigurt se këto aspekte pozitive janë të qëndrueshme dhe nuk do të çrregullohen në të ardhmen, për shembull, nga ndryshimet e Qeverisë. Si në vendet e BE-së, ligji nr.9918 vendos kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të këshillit të organit rregullator.

Ligji nr.9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” rrjedh nga politikat për komunikimet elektronike “...nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efëcente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë“. Legjislacioni përcakton rolin e ministrit në bashkërendimin e aktiviteteve ndërkombëtare, në planifikimin kombëtar të spektrit të frekuencave dhe në procedurat për caktimin e frekuencave, në miratimin e ofruesit të shërbimit universal dhe në çështjet lidhur me komunikimet elektronike për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare.

Legjislacioni gjithashtu përcakton rolin e autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare (AKEP-it) si një person juridik publik, i pavarur dhe jobuxhetor. Zhvillimi i vazhdueshëm i teknologjisë dhe paketës së shërbimit të zgjedhur nga përdoruesit fundorë e nxisin ndryshimin e shpejtë të tregut dhe AKEP-i duhet të mbajë njohuri të plotë mbi këto ndryshime. Ligji i jep AKEP-it fuqitë e duhura për të arritur këtë dhe do t'i sigurohet buxheti i duhur për t,u bërë qendër e njohurive të specializuara ku mund të mbështeten lojtarët e tregut, Ministria dhe agjencitë e tjera të Qeverisë për të siguruar realizimin e objektivave të politikave kombëtare. Në thelb të punës së AKEP-it është detyrimi për të zhvilluar këshillime publike para marrjes së vendimeve rregullore për tregun. Ruajtja e pavarësisë, roli si këshillues dhe ekspert janë kyç për ruajtjen e besimit të investitorëve dhe konsumatorëve, tani dhe në të ardhmen.

Përveç detyrimeve ligjore për t'iu përgjigjur aplikimeve dhe përfaqësuesve nga publiku i gjerë brenda afateve kohore, nga AKEP gjithashtu kërkohet të paraqesë para Kuvendit një raport vjetor mbi aktivitetin e tij dhe ta publikojë në fund të çdo viti. Ky raport përfshin një plan veprimi për punën e planifikuar në vitin pasardhës ,si dhe një analizë të punës së bërë.

Përfundimisht, komunikimet elektronike të cilësisë së mirë dhe me çmim të ulët kontribuojnë në efikasitetin e shumicës së sektorëve të tjerë të ekonomisë. Mungesa e progresit në këtë fushë të rëndësishme do të frenonte ekonominë në përgjithësi. Si edhe niveli dhe efikasiteti i sektorit bankar, edhe komunikimet elektronike janë “sistemi nervor” i një ekonomie moderne.

1.3 Tregu i përbashkët i BE-së

Qysh nga viti 1987, autoritetet brenda BE-së kanë zbatuar liberalizimin e sektorit të komunikimeve elektronike si përgjigje ndaj zhvillimeve të teknologjisë, të cilat kanë pasur ndikim në të gjithë botën. Kuadri rregullator i BE-së për këtë sektor qëndron në themelet e dispozitave për konkurrencën në Traktatin e BE-së. Kuadri kërkon që autoritetet kombëtare të rregullojnë sektorin

6 Autoriteti i konkurrencës dhe autoriteti i komunikimeve elektronike dhe postare (AKEP)

në përputhje me rregullat e përgjithshme. Zbatueshmëria e këtyre rregullave monitorohet nga Komisioni Europian dhe nëse është e nevojshme, merren masa për zbatimin nga autoritetet kombëtare nëpërmjet masave ligjore para Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Kuadri rregullator i BE-së është çmuar gjerësisht dhe është ndjekur edhe nga vende jashtë BE-së. Vendet të cilat përgatiten për anëtarësim në BE, inkurajohen posaçërisht që ta zbatojnë.

Në kërkim të zbatimit të kuadrit rregullator të BE-së para anëtarësimit në BE, Shqipëria ndjek qëllimin, i cili bazohet kryesisht në interesat vetjake ekonomike. Kjo bëhet thjesht për të përmbushur kushtet e BE-së për anëtarësim, edhe pse kërkohet për atë qëllim gjithashtu. Një regjim rregullator si ky, do të ishte shumë i nevojshëm edhe nëse Shqipëria nuk anëtarësohet në BE. Kuadri rregullator i BE-së nuk është i pandryshueshëm. Direktivat e mirënjohura të vitit 2002 janë rishikuar kohët e fundit në mënyrë që të merren parasysh zhvillimet e vazhdueshme të tregut dhe grumbullimi i përvojës rregullatore. Brenda BE-së, rregullat e reja të vitit 2009⁷ duhet të bëhen të efektshme jo më vonë se në maj të vitit 2011.

Për të ecur në një hap me praktikën rregullatore dhe zhvillimet e politikave në BE, Shqipëria do të ndjekë për së afërmi agjendën dhe aktivitetet e komiteteve dhe grupeve⁸, të cilat janë ndërtuar për të mbajtur një vazhdimësi ndërmjet të gjitha vendeve europiane, të cilat janë në BE ose kanë për qëllim të anëtarësohen. Prandaj, sfida kryesore në këtë fushë është të arrihet pajtueshmëri e plotë me kuadrin rregullator të BE-së dhe të mbahet vazhdimësia e këtij pozicioni deri sa të jetë arritur anëtarësimi. Prandaj, Qeveria ka vendosur, që në rastin e parë të mundshëm, të transpozojë ndryshimet e vitit 2009 në ligjin shqiptar dhe do t'i prezantojë Kuvendit legjislativ e amenduar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2010. °

Siç është edhe në BE, regjimi rregullator shqiptar është krijuar në mënyrë që t'i mundësojë AKEP-së të trajtojë me efikasitet situatën dhe sjellje me të cilat një rregullator mund të ballafaqohet. Drejtimi i përgjithshëm i rregullatorit duhet të jetë drejt heqjes së detyrimeve rregullatore dhe zbutjes së kufizimeve kur konkurrenca e qëndrueshme të jetë arritur, por, si një lloj si organet rregullatore në BE, AKEP-it i është dhënë fuqia dhe i kërkohet që të mbajë masat rregullatore të nevojshme në fuqi ku këto janë të justifikueshme. Me marrjen e masave rregullatore duhet pasur parasysh interesat e përdoruesve dhe të investitorëve, por do të ishte fatkeqësi nëse këto dy palë shihen si palë në konflikt. Nëse konkurrenca (e plotësuar, ku është e nevojshme, me masa rregullatore) nuk mund t'i sjelli çmimet e shërbimeve të lëvizshme bazë, zanore dhe SMS, në përputhje me normat e tregut të BE-së, konsumatorët tanë me të drejtë do të konsideronin politikën tona si të papërshtatshme dhe do të kërkonin masa të mëtejshme.

Situata lidhur me shërbimet e tjera dhe posaçërisht për shërbimet e avancuara me brez të gjerë (*broadband*) është tjetër, pasi është e qartë se zgjerimi i shërbimeve të reja është në interes të përdoruesve.

Nuk është menduar asnjëherë se zhvillimi i tregut shqiptar do të ishte i ngjashëm me përvojat e zakonshme të vendeve të BE-së, në të cilat një operator inkumbent shumë dominant ka pasur burime njerëzore dhe fizike shumë të mëdha, si dhe një prezencë pothuajse të plotë të shërbimit universal. Kjo do të thotë se gjatë aplikimit të kuadrit rregullator të BE-së në Shqipëri, AKEP-i mund të bëjë zgjedhje të cilat mund të mos jenë përdorur në vendet e tjera. Për shembull, në varësi të rrethanave dhe kushteve, kuadri i jep fuqi AKEP-it të arrijë në konkluzionin se detyrimet rregullatore nuk është e nevojshme të jenë të njëjta në të gjithë vendin.

7 Direktiva 2009/136/EC (e cila ka të bëjë kryesisht me të drejtat e përdoruesve), Direktiva 2009/140/EC (e cila ka të bëjë me kornizën rregullatore) dhe rregullorja (EC) 1211/2009 (e cila rithemelon grupin e rregullatorëve europianë me një bazë më të fortë institucionale tashmë e njohur si BEREC).

8 Komisioni i komunikimeve, komisioni i radio spektrit, grupi i politikave për radio spektrin, organi i rregullatorëve europianë për komunikimet elektronike (BEREC) dhe grupi i punës për mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin e të dhënave personale.

1.4 Marrëdhënia me dokumentin e mëparshëm të politikave

Dokumenti kryesor i politikave, i cili do të zëvendësohet nga ky dokument është miratuar në vitin 1999. Qysh atëherë ka pasur ndryshime dramatike në këtë sektor, të cilat do të kërkonin rishikimin e këtij dokumenti. Megjithatë, ndryshimi kryesor është se dokumenti i mëparshëm i ka përshkruar veprimet që do të ndërmerren në të ardhmen nga Qeveria, shumica e të cilave janë përmbushur edhe pse një pjesë me shumë vonesë, ose janë bërë pjesë e fuqisë ligjore dhe i janë transferuar organit të pavarur rregullator, AKEP-it⁹. Ligji nr.9918 vërteton zhvendosjen domethënëse të fuqive vendimmarrëse nga Qeveria te rregullatori (AKEP-i), i cili duhet të marri vendime të pavarura bazuar në analizat ekonomike, në veçanti të analizës së tregut siç është përshkruar në Direktivat e BE-së. Është thelbësore për suksesin e këtij dokumenti të politikave që AKEP-i t'i ushtrojë pa vonesë dhe me vetiniciativë fuqitë ,të cilat i janë caktuar.

Ky dokument fillon nga ligji dhe gjendja aktuale e tregut. Për këtë sektor, detyra kryesore e Qeverisë në të ardhmen do të jetë të sigurojë integrim sa më të përafërt të Shqipërisë në politikëbërjen dhe strukturat rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, si dhe të garantojë që veprimet e ndërmarra në sektorët e tjerë janë koherente në ritmin e zhvillimit dhe në qëllimin e tyre. Përveç këtyre, përgjegjësitë e tjera ,të cilat dalin nga marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë, ngarkojnë ministrin me kompetenca të caktuara në fushën e politikave të spektrit, si dhe në lidhje me ofrimin e shërbimit universal. Natyrisht, ministri mbetet përgjegjës gjithashtu për të përgatitur politikat dhe për të propozuar ligje të reja në këtë sektor ose për t'i amenduar ato dhe për këto arsye, e ka për detyrë të marrë parasysh efikasitetin e regjimit të krijuar me ligjin nr. 9918 dhe t'i paraqesë herë pas here qëndrimet e tij para Kuvendit.

1.5 Fushëveprimi i gjerë i politikës

Fusha e komunikimeve elektronike ka lidhje të ngushta me disa politika të fushave të tjera. Për të siguruar koherencë në trajtimin e përgjithshëm të këtyre politikave, është e rëndësishme që këto lidhje të merren parasysh kur ndërmerren ose konsiderohen veprime ose iniciativa në shumë fusha të Qeverisë. Për këtë arsye, ky dokument përfshin referenca, të cilat nuk janë drejtpërdrejt brenda fushës së veprimit të nenit 5 të ligjit nr.9918. Ato janë përfshirë në këtë dokument pa paragjykim ndaj dispozitave të tjera ligjore. Në veçanti, vazhdimësia do të mbahet pasi që strategjitë për televizionin digjital dhe shoqërinë e informacionit vazhdojnë të zhvillohen dhe të përmirësohen.

Ecuria mund të përshpejtohet edhe nëpërmjet bashkëpunimit me vendet e tjera. Shqipëria është pjesë e iniciativës eSEE (electronic South Eastern Evrope) dhe bSEE (broadband South Eastern Evrope). Me nënshkrimin e eSEE Agenda+ në tetor të vitit 2007, Shqipëria rikonfirmoi dëshirën dhe vendosmërinë për të përparuar drejt botës digjitale dhe në radhitjen e objektivave të saja afër me ato të vendeve të BE-së siç është përcaktuar në kuadrin e politikave (të njohur si i2010) për shoqërinë e informacionit dhe për media për periudhën deri 2010. Komisioni Europian është duke punuar aktualisht në agjendën e re digjitale nën titullin: "Post-i2010: prioritetet për një strategji të re për shoqërinë europiane të informacionit (2010-2015)". Qëllimi i Qeverisë është që dokumenti i politikave të mbetet në përputhje me agjendën më të gjerë sa herë që ajo të përditësohet.

KAPITULLI 2

SITUATA AKTUALE E TREGUT SHQIPTAR

Hyrje

Situata e sotme në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri ende vuan pasojat e neglizhencës së jashtëzakonshme ndaj telefonisë fikse gjatë katër dekadave para vitit 1990. Kjo ka pasur një efekt ekstrem në zhvillimin e mëtejshëm duke shkaktuar që rrjetet e lëvizshme dhe (të transmetimeve radiotelevizive) kanë pasur një rritje të domethënëse me pak mbështetje tek operatori inkumbent. E kundërta ndodh me hyrësit e rinj të rrjeteve fikse ,të cilët përballen me vështirësi më

⁹ AKEP - autoriteti i komunikimeve elektronike dhe postare

të mëdha në shtrirjen e rrjetit për të arritur te konsumatorët potencialë. Ata janë shumë të varur nga bashkëpunimi i operatorit ende të pazhvilluar inkumbent por, gjithashtu përballen edhe me problemet e aksesit në prona të cilat janë një pengesë e madhe për këta operatorë.


TELEKOMUNIKACIONET

2.1 Telefonia e lëvizshme

Në maj të vitit 1996, Shqipëria u bë një nga vendet e para në rajon, e cila licencoi një operator GSM. Tani janë tri kompani të cilat operojnë në tregun e telefonisë së lëvizshme, AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile. Spektri është i disponueshëm edhe për operatorin e katërt dhe licenca është lëshuar në shtator 2009, megjithëse shërbimi nuk është ofruar ende. Aktualisht, sipas të dhënave të fundit të vitit 2009, janë gati 130 celularë për 100 banorë. Rritja e këtij sektori është përsheptuar në vitin 2008-2009 dhe kompania më e tretë në treg, Eagle Mobile, kishte 260 000 pajtimtarë në fund të vitit 2008 dhe afërsisht 480604 në vitin 2009/1. Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme.

Sektori i komunikimeve elektronike është një ndër sektorët e ekonomisë shqiptare me rritjen më të lartë në vitet e fundit. Të ardhurat totale të sipërmarrësve të autorizuar nga AKEP-i, për vitin 2008, ishin rreth 500 milionë euro¹⁰, që përbën 5.76% të GDP-së Shqipërisë 8 665 milionë euro¹¹. Katër aktorët kryesorë, Altelekom (operatori fiks, inkumbent), Albanian Mobile Communication (AMC), Vodafone Albania dhe Eagle Mobile (tre operatorë celularë) zotërojnë 96% të të ardhurave të gjithë sektorit; Altelekom (16%), AMC (38%); Vodafone (41%); Eagle Mobile (1%) dhe sipërmarrësit e tjerë (4%).

Figura 1. Të ardhurat e operatorëve të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2008



Burimi: Të dhënat periodike të operatorëve dërguar AKEP-it.

Figure 1. Përdoruesit e telefonisë Mobile sipas operatorëve për 2003-2009/1





Figura 2. Ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë celulare dhe norma e penetrimit 2003 - 2009/1




Sipas kompanive, të cilat operojnë në treg, aktualisht më shumë se 99% e popullsisë dhe më shumë se 88% e territorit të Republikës së Shqipërisë mbulohet me sinjal GSM. Në vitin 2008, 93.5% e të gjithë pajtimtarëve i përkisnin shërbimeve me parapagim. Operatorët GSM ofrojnë shërbim zanor, tekst dhe shërbime të gjeneratës 2.5. Shërbimi GPRS është prezent në të gjithë territorin e Shqipërisë, kurse EDGE vetëm në qytetet kryesore.

2.2 Telefonia fikse

Albtelekom është operatori inkumbent në tregun e telefonisë fikse dhe deri në fund të vitit 2009 janë regjistruar 73 operatorë alternativë disa prej të cilëve kryesisht në zonat rurale. Madhësia e vërtetë dhe natyra e tregut të operatorëve alternativë aktualisht nuk është shumë e qartë dhe do të


qartësohet kur AKEP-i të ketë përfunduar të analizojë tregjet përkatëse siç kërkohet sipas ligjit nr.9918. Rrjetet e tyre mund të kërkojnë investime serioze në mënyrë që të ofrojnë akses me brez të gjerë (*broadband*) dhe kjo do të duhej të bëhej në konkurrencë me operatorët e tjerë alternativë ,të cilët do të jenë të disponueshëm shpejt.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka shënuar rritje të ulët viteve të fundit. Numri i linjave të Albtelekomit pothuajse nuk ka ndryshuar gjatë katër viteve e fundit dhe rritja e numrit të pajtimtarëve është rezultat i hyrjes së operatorëve të rinj në treg. Tabela e mëposhtme paraqet progresin e pajtimtarëve të telefonisë fikse (të dhënat e marra nga AKEP):



Burimi: AKEP

Figura 3. Ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë fikse 2003 - 2009/1




2.3 Shërbimet e brezit të gjerë (*Broadband*)

Shërbimet me brez të gjerë ofrohen nga operatorët e rrjeteve fikse (aktualisht nuk ka ofrues të lëvizshëm me brez të gjerë)

Në qershor 2009 vlerësohet të kenë qenë përafërsisht 80 000 lidhje me brez të gjerë, me nivel penetrimi rreth përafërsisht 2.5 për 100 të popullsisë, që mbetet më e ulëta në Europë (shih grafikun më poshtë).

Penetrimi i brezit të gjerë fikse



Penetrimi i brezit të gjerë mbetet më i ulëti në Europë dhe me vetëm një të tretën e mesatares së nivelit të Europës Jug-lindore

(Burimi: Cullen International ¹²)

Nga 80 000 lidhje me brez të gjerë, në fund të viti 2009, Albtelekom kishte 52 000 lidhje ADSL, pjesa tjetër nga operatorët alternativë, të gjithë duke përdorur teknologjinë xDSL.

2.4 Shërbimet e internetit

Nga qershori 2008 ofrimi i shërbimit të internetit ka pasur ndryshime të rëndësishme nëpërmjet rritjes së numrit të ofertave dhe reduktimit të tarifave për akses në internet brez të gjerë. Gjithashtu, është vënë re se një numër sipërmarrësish kanë filluar të ofrojnë paketa trefishe (triple play) telefoni, internet dhe televizion. Gjatë kësaj periudhe, Albtelekom ka qenë shumë aktiv në shërbimet e aksesit në internet, duke reduktuar tarifën e shërbimit me brez të gjerë, nëpërmjet ADSL, me më shumë se 50%. Deri në 31.12.2009, numri i përdoruesve me brez të gjerë nëpërmjet ADSL të Albtelekom, ishte afërsisht 52000, çka përbën një rritje të konsiderueshme në krahasim me korrik 2008, ku numri i këtyre përdoruesve ishte rreth 1400. Gjithashtu, rritje të konsiderueshme vlerësohet të kenë pasur operatorët alternativë, të cilët ofrojnë akses me brez të gjerë në internet nëpërmjet infrastrukturës së tyre me shpejtësi të lartë bazuar në teknologji ADSL2+ dhe fibër optike. Në këtë periudhë edhe operatorët celularë kanë qenë shumë aktive në ofrimin e shërbimeve të internetit nëpërmjet aparateve celulare duke ofruar reduktime të ndjeshme të tarifave të këtij shërbimi për përdorues me kontratë dhe me parapagim.


12 Raporti studimor i ndërmjetëm III "Monitorimi i komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të shoqërisë së informacionit në vendet në zgjerim", Forum 3 – Budva, Montenegro Feb 4-5, 2010

Në tregun e shërbimeve të Internetit me ose pa brez të gjerë në Shqipëri janë rreth 31 operatorë. Ata janë kryesisht aktivë në Tiranë dhe në qytetet në perëndim të vendit. Aktualisht nuk ka të dhëna të besueshme për numrin e pajtimtarëve të cilët kanë akses në Internet me brez të gjerë, por mendohet të jenë përafërsisht deri në fund të vitit 2009 rreth 80000-90000 pajtimtarë. Nga këta 52.000 te Albtelekom. Nga këta 20.000 janë pajtimtarë të Albtelekomit. Bazuar në këto të dhëna, penetrimi i shërbimeve me brez të gjerë është më pak se 2.5 në 100 banorë.

Operatorët të cilët ofrojnë shërbime me brez të gjerë (përveç Albtelekom-it) e kanë zhvilluar aktivitetin e tyre kryesisht në Tiranë ku jeton 30% e popullsisë së Shqipërisë dhe ku kërkesa është më e madhe. Shumica e pajtimtarëve të Internetit me brez të gjerë në Tiranë marrin këtë shërbim nëpërmjet teknologjisë ADSL dhe teknologjisë Hybrid Fiber-Coax. Pak pajtimtarë marrin këtë shërbim nëpërmjet aksesit wireless. Një rritje e papritur e pajtimtarëve të ADSL është parë në vitin 2008, pasi që disa kompani kanë investuar në zgjerimin e rrjeteve të tyre.

Mungesa e lidhjeve me kapacitet të lartë me vendet fqinje nga të cilat merret lidhja e Internetit mbetet një problem i madh. Me përjashtim të Albtelekom, i cili ka fibra optike lidhur me Italinë, operatorët e tjerë përdorin lidhje mikrovalore për të siguruar shërbimet e Internetit nga vendet fqinje.

Numri i përdoruesve të Internetit në Shqipëri është rritur dukshëm gjatë viteve të fundit, gjë që është e lidhur me penetrimin e aksesit të Internetit me brez të gjerë. Grafiku më poshtë paraqet rritjen e numrit të përdoruesve të Internetit gjatë tri viteve të fundit:



Burimi: <http://www.internetworldstats.com/stats4.htm#europe>

Në konkurrencë me Albtelekom, operatorët kryesorë të shërbimeve me brez të gjerë në treg janë: Abissnet, ABCOM, Alfa Cable, ASC, etc. Rritja gjatë kohëve të fundit e rrjeteve fikse në Tiranë ka fokusuar vëmendjen në problemet e aksesit në infrastrukturën e nëntokësore dhe aspektet lidhur me lejet për akses ose për ndërtim.

2.5 Shërbime e tjera të telekomunikacionit

Për shkak të numrit të madh të shqiptarëve jashtë shtetit dhe për shkak të tarifave të larta të ofruara nga operatorët e tjerë të telefonisë, thirrjet me shërbimet e kartave me parapagesë ose nëpërmjet call centres kanë pasur sukses. Liberalizimi i plotë i tregut shqiptar ka shkaktuar një ulje domethënëse të tarifave të thirrjeve ndërkombëtare.

TRANSMETIMET RADIO-TELEVIZIVE

Shtojca 1 e këtij dokumenti ofron një përshkrim të situatës në fushën e transmetimeve radio-televizive të përgatitur nga KKRT.

Pjesa tjetër e këtij dokumenti fokusohet kryesisht në politikat e sektorit të telekomunikacioneve. Politika të veçanta për sektorin e transmetimeve radiotelevizive do të mbulohen në dokumente të veçanta.

KKRT-ja ka ndërmarrë nismën dhe ka hartuar një projekt të “Strategjisë për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike”.

Projekti i Strategjisë përcakton objektivat dhe parimet kryesore të, kalimit në sistemin numerik, rolin e shtetit dhe të strukturave përkatëse shtetërore në krijimin e kushteve të përshtatshme për kalimin në sistemin numerik, vlerëson gjendjen ekzistuese teknike dhe ligjore të sektorit audiovizual shqiptar dhe propozon hapat, procedurat, kostot dhe afatet e kalimit brenda 2 viteve të ardhëshme.

Në përfundim të fazave të këshillimit (publik dhe institucional), Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit i propozoi Kryetarit të Këshillit të Ministrave përcaktimin e modaliteteve të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e Task-Forcës që do të miratojë variantin final të Strategjisë.

Më datë 02.06.2009, ka dalë Urdhri nr. 7 i Kryeministrit për “Ngritjen e Komitetit ad hoc për strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në digjitale”.

KAPITULLI 3

LIGJI 9918 PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

3.1 Ligji i ri i Shqipërisë

Një nga risitë kryesore të ligjit 9918 është futja e autorizimit të përgjithshëm dhe nga kjo rrjedhin pasoja të rëndësishme. Ky ligj jep të drejtën e përgjithshme për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë me një minimum të detyrimeve administrative. Kjo, në veçanti do të thotë se operatorët ekzistues të rrjeteve fikse mund të zgjerojnë lirisht ofrimin e shërbimeve të tyre në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ndërtimit të rrjetit ose nëpërmjet interkonjeksionit me rrjetet e tjera. Gjithashtu, do të thotë se pronarët e çdo infrastrukture tjetër të rrjeteve që mund të ofrojë shërbime të komunikacioneve (siç janë TV kabllorë ose sistemet e përdorura vetëm për qëllime private) mund t’i ofrojnë shërbime çdo personi. Ku kërkohet përdorimi i spektrit dhe ku kërkohet caktimi i numrave nga Plani Kombëtar i Numeracionit, ofruesit e shërbimeve do të duhet të kërkojnë autorizim për këto nga AKEP-i, ose lidhur me spektrin e transmetimeve radiotelevizive, nga KKRT-ja. Tarifatat që do të aplikohen për përdorim të këtyre burimeve rregullohen me ligj si dhe me legjislacionin dytësor.

Një risi tjetër e rëndësishme është se detyrimet tregtare rregullatore (siç është kontrolli i çmimeve), do të aplikohet vetëm për operatorët me fuqi të ndjeshme në treg dhe këto detyrime do të hiqen vetëm nëse konkurrenca është e mjaftueshme për të mbrojtur konsumatorin. Instrumenti kryesor për të vlerësuar efikasitetin e konkurrencës është dhe do të jetë analiza e tregut.

Analiza e tregut do të drejtohet nga AKEP-i, një agjenci e cila është krejtësisht e pavarur dhe i përgjigjet vetëm Kuvendit dhe gjykatave.

Analiza e tregut bazohet në të dhënat e tregut dhe parimet e ligjit Evropian të konkurrencës: nuk është subjekt i influencës politike

AKEP mund të zgjedhë ndërmjet detyrimeve të caktuara rregullatore, duke zgjedhur ato të cilat janë më të përshtatshme për situatën e shfaqur nga analiza. Detyrimet rregullatore mund të vazhdojnë (ose të vendosen nga fillimi) vetëm nëse ato janë të nevojshme dhe proporcionale.

3.2 AKEP - mbrojtës i fuqishëm i operatorëve dhe përdoruesve

Ligji 9918 cakton AKEP-in si rregullator të pavarur të Shqipërisë dhe i jep atij të gjitha fuqitë e nevojshme për të garantuar që ofruesit e shërbimeve mund të hyjnë në treg pa vonesa ose formalitete. AKEP-i gjithashtu ka për detyrë të promovojë konkurrencën dhe ka fuqitë për të imponuar detyrimet për të garantuar zbatimin e ligjit, dokumentit të politikave për komunikimet elektronike si dhe rregulloretë të hartuara sipas ligjit.

Bazuar në këtë ligj, AKEP-i ka fuqi të mjaftueshme për të parandaluar sjelljet abuzive (siç është aplikimi i tarifave tepër të larta ose refuzimi për të ofruar shërbimin) nga sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg. Ligji 9918 kërkon përcaktimin e sipërmarrësve me FNT të paktën çdo dy vite, më përpara janë përcaktuar çdo vit. Ligji 9918 gjithashtu ndryshon përcaktimin e 'fuqisë së ndjeshme në treg', në krahasim me ligjin e mëparshëm si dhe e lehtëson këtë proces.

Ligji 9918 i detyron sipërmarrësit me FNT të ofrojnë infrastrukturën e tyre në dobi të palëve të treta për të siguruar zgjerimin edhe të operatorëve pa FNT.

Për të siguruar pavarësinë dhe objektivitetin e AKEP-it, fuqitë e tija i ngarkohen Këshillit Drejtues prej pesë anëtarësh të emëruar nga Kuvendi i Republikës. Ky organizim thelbësor ka për qëllim ti sigurojë investitorët që ata mund të presin trajtim të drejtë dhe profesional nga AKEP-i. Gjithashtu siguron Kuvendin e Shqipërisë dhe qeverinë që fuqitë kryesore që i janë dhënë AKEP-it do të ushtrohen në mënyrë të balancuar dhe jo nga zyrtarë individualë. Në funksion të ankimeve, Këshilli Drejtues i AKEP-it kryen funksione të mirëfillta administrative siç kërkohet nga neni 6 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Qeveria dëshiron të sigurojë investitorët e rinj në tregun e komunikimeve elektronike të Shqipërisë që sektori do të rregullohet në një mënyrë që i referohet sa më shumë të jetë e mundur rregullave të vendeve të BE-së. Konsumatorët e tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri mund të jenë të sigurt që disponueshmëria e shërbimeve konkurruese do të vazhdojë të rritet dhe çmimi, cilësia dhe shumëllojshmëria e shërbimeve do ta reflektojnë këtë fakt. Ligji përmban masa të ndryshme të cilat mundësojnë mbrojtjen e konsumatorëve duke përfshirë ato që kërkohen me acquis të BE-së për komunikimet elektronike. Shumica e detyrave për mbrojtjen e konsumatorëve janë në përgjegjësi të AKEP-it dhe fuqitë të cilat ato i kanë do të ushtrohen paralel dhe në bashkëpunim me agjencitë përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve në përgjithësi.

Një metodologji për rregullimin e disa tarifave të caktuara është miratuar nga qeveria duke përdorur fuqitë sipas ligjit 8618 për telekomunikacionet pak para se ligji 9918 të hynte në fuqi. Kontrolli i çmimeve si rezultat i këtij vendimi mbetet në fuqi deri sa të jenë bërë analiza të plota të tregjeve përkatëse sipas ligjit 9918, të cilat janë bërë pjesërisht dhe deri sa AKEP-i të arrijë në përfundim se shkalla e konkurrencës lejon kryerjen e ndryshimeve në detyrime.

Ka pasur një ulje domethënëse të çmimeve për shërbimet e telefonisë së lëvizshme që nga hyrja në fuqi e metodologjive dhe duket qartë se presioni i konkurrencës është rritur me hyrjen në treg të operatorit të tretë. Operatori i katërt celular tashmë është autorizuar dhe kjo ka ndikuar në rritjen e zgjedhjeve për konsumatorët dhe ndryshime të reja në treg të ofruara nga operatorët. Mënyra më e mirë për të ecur përpara aktualisht është monitorimi i tregut dhe marrja e masave të përshtatshme nga AKEP-i. Nëse ofruesit e rinj të shërbimit të telefonisë së lëvizshme ose operatorët e rrjeteve të lëvizshme virtuale dëshirojnë të hyjnë në treg, kjo gjithashtu është e mundur sipas rregullave aktuale.

Portabiliteti i numrit është elementi kryesor i cili i mundëson zgjedhje konsumatorit dhe gjithashtu promovon konkurrencën në tregun e telefonisë dhe AKEP-i tashmë ka filluar procedurat e nevojshme për të bërë të mundshëm portabilitetin të numrit sipas nenit 88 të ligjit 9918. Portabiliteti i numrit i mundëson pajtimtarëve të mbajnë të njëjtin numër kur ata e ndryshojnë operatorin. Për të ofruar këtë lehtësi operatorët duhet të bëjnë ndryshime në rrjetet e tyre. Ligji kërkon që operatorët të mbulojnë kostot për këto ndryshime dhe tarifat e portabilitetit të numrit të jenë të orientuara drejt kostos. Ky facilitet tashmë është me vonesë dhe operatorët duhet të bashkëpunojnë plotësisht me AKEP-in për të zbatuar portabilitetin e numrit pa vonesa të mëtejshme.

Portabiliteti i numrit pritet t'i mundësojë konsumatorëve përfitime të mëdha, veçanërisht pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme. Qeveria pret që procedurat dhe formalitetet e nevojshme për të bartur një numër të jenë të sa më të shkurtra dhe sa më të thjeshta. Progresi në këtë fushë pritet të mundësojë zgjedhje më të madhe për konsumatorët, shërbime më cilësore dhe çmime më të ulëta. Këto përfitime mund të përshpejtohen edhe nga disponueshmëria e informacionit cilësor lidhur me tarifat konkurruese.

Vetë AKEP-i financohet nga një pagesë e ulët që i është vendosur kompanive të cilat operojnë në këtë sektor dhe nuk është një detyrim për taksa-paguesit në përgjithësi. Kjo nuk i jep AKEP-it mundësinë të shpenzojë pa kujdes, megjithatë ligji 9918 vendos një limit maksimal prej 0.5% të të ardhurave vjetore që kompanitë kërkohen të paguajnë për këtë qëllim. AKEP-i gjithashtu arkëton për qeverinë tarifat për përdorimin e spektrit dhe numrave. Kjo shumë nuk kalon në buxhet të AKEP-it dhe nuk mund të konsiderohet si një tregues i rregullimit të pagesave në AKEP. Qeveria është në dijeni për çështjet lidhur me tarifat për spektrin prandaj ka për qëllim të rishikojë politikën e saj në këtë fushë, si lidhur me nivelin e tarifave ashtu edhe me përgjegjësinë për arkëtimin e tyre.

AKEP-i është i detyruar ti raportojë Kuvendit çdo vit. Nga ky raport mund të shihet se AKEP-i tashmë ka filluar të zbatojë ligjin e ri, por mbetet ende punë për tu bërë. Këto raportime vjetore do të formojnë një bazë të dhënash të ecurisë në këtë sektor dhe së bashku me materialin dhe opinionet nga burime të tjera, do të ofrojnë bazën për çdo ndryshim të nevojshëm të ligjit në të ardhmen. Pritet që Kuvendi të shfaqë një interes më të madh për suksesin e AKEP-it, si për rregullimin e tregut ashtu edhe për menaxhimin e shpenzimeve të tij.

Qeveria veçanërisht mirëpret qëllimet e AKEP-it – siç është theksuar në raportin e parë vjetor – për të konsoliduar organizimin e AKEP-it për mbrojtjen e konsumatorëve dhe informacionit si dhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve.

II - Vizioni

KAPITULLI 4 KONVERGJENCA E TELEKOMUNIKACIONEVE DHE TRANSMETIMEVE RADIO- TELEVIZIVE

Bota e komunikimeve elektronike tradicionalisht është trajtuar si e ndarë ndërmjet:

- komunikimeve private (siç janë thirrjet telefonike ndërmjet dy njerëzve) të cilat janë parë si të fshehta dhe të pacensuruara. Gjithashtu, privatësia duhet garantuar me ligj dhe duhet të aplikohen procedura të ashpra kontrolli nga çdo autoritet i cili në mënyrë të veçantë të përgjojë komunikimet private për hetime të krimeve të rënda. Përgjimi i ligjshëm rregullohet me ligj të posaçëm.

- transmetimet televizive (siç janë televizionet publike) ku në përgjithësi është i nevojshëm një nivel i kontrollit rregullator mbi përmbajtjen që transmetohet në publik. Pasi komunikimet e transmetuara mund të keqpërdoren lehtësisht dhe kontrollet e krijuara për rregullimin e transmetimit duhet të sigurohen në mënyrë që mos ti shërbejnë interesave të qeverive por gjithashtu duhet të parandalojnë çdo lloj tjetër abuzimi. Si anëtare e Këshillit të Evropës, Shqipëria ka detyrime lidhur me këto çështje.

Kjo ndarje e gjerë ka qenë aq e qartë sa ndryshimi ndërmjet telefonit dhe televizionit është e dukshme edhe sot në jetën e përditshme të popullsisë. Megjithatë, përparimi i vazhdueshëm i teknologjisë ka filluar ta zbehë kufirin ndërmjet asaj që konsiderohet private dhe publike. Për shembull, mesazhet e padëshiruara elektronike dërguar mijëra njerëzve të panjohur për dërguesin kanë të bëjnë më shumë me transmetimin se sa me një bisedë private. Një film i regjistruar në mënyrë digjitale i cili shihet në televizionin kabllor nga një individ i cili pagan një tarifë të ulët mund të konsiderohet si komunikim privat edhe pse i njëjti film mund të kërkohet nga çdokush që dëshiron ta shohë.

Konvergjencia në rritje e teknologjisë së përdorur për dy klasa të konsideruara më parë të ndryshme bëri që politikë-bërësit e BE-së të zgjerojnë fushëveprimin e kuadrit rregullator në vitin

2002. Kuadri i mëparshëm i referohej vetëm telekomunikacioneve kurse kuadri i vitit 2002 përdoret për të gjitha komunikimet elektronike. Ligji 9918 është miratuar në vitin 2008 por ende nuk zbatohet plotësisht për të gjithë fushën e rrjeteve dhe shërbimeve.

Dy pjesë të rëndësishme të kësaj fushe të cilat janë aktualisht të përjashtuara nga aplikimi i ligjit 9918 janë:

- Rregullimi i përmbajtjes së transmetimeve televizive nëpërmjet rrjeteve.
- Transmetimet radiotevizive (*broadcasting*).

4.1 Rregullimi i përmbajtjes së transmetimeve televizive nëpërmjet rrjeteve

Përjashtimi i mundësisë së rregullimit të përmbajtjes së komunikimeve private është në përputhje me nevojën për privatësi. Lidhur me transmetimet radiotevizive, rregullimi i përmbajtjes bëhet nëpërmjet ligjit 8410, datë 30.09.1998, për Televizionet dhe Radiot Private dhe Publike dhe kompetencat e nevojshme i janë caktuar KKRT-së. Ky dokument i politikave nuk jep propozime të detajuara për ndryshimin e këtyre kompetencave. Megjithatë, qeveria pret që me zhvillimin e vazhdueshëm të tregjeve dhe teknologjisë do të shfaqet nevoja për rishikimin e fushëveprimit dhe nevojës për të rregulluar përmbajtjen që transmetohet nëpërmjet mënyrave të tjera përveç radios dhe televizionit tradicional. Një studim i gjerë do të zhvillohet gjatë vitit 2010 me qëllim përgatitjen e rekomandimeve për çdo ndryshim të nevojshëm në ligj dhe praktika. Kjo do të reflektohet në ligjin e ri “Për transmetimet me zë e figurë” që po përgatitet nga një grup pune pranë Komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik të Kuvendit, i cili do të zëvendësojë ligjet ekzistuese që aktualisht rregullojnë mediat audiovizuale.

4.2 Transmetimet radio dhe televizive

Përjashtimi i transmetimeve radiotevizive nga fushëveprimi i këtij ligji e ka origjinën në ndarjen e vjetër, fizike, ndërmjet rrjeteve të telekomunikacioneve dhe transmetimeve televizive të cilat tashmë nuk ndryshojnë në përdorimin e tyre. Megjithatë, tendencat e kohëve të fundit në administrimin e spektrit janë që të liberalizohet përdorimi i tij. Strategjitë e ardhshme tani duhet të bëhen duke marrë parasysh se së shpejti i gjithë spektri që nuk përdoret për nevoja qeveritare në përputhje me PKRF mund të përdoret për komunikime elektronike. Kjo do të thotë për telekomunikacione ose transmetime televizive, ose për të dyja. Në të ardhmen menaxhimi i gjithë spektrit për përdorim civil do të duhet të jetë nën të njëjtin ligj. Kjo nuk është ende urgjente, megjithatë, rishikimi i ligjeve të transmetimeve televizive tashmë është planifikuar. Deri në një situatë kur kushtet të jenë gati, probleme praktike mund të shmangen duke përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet KKRT-së dhe AKEP-it me një memorandum zyrtar të mirëkuptimit për çështje lidhur me menaxhimin e spektrit të radios duke përfshirë mbikëqyrjen e aspekteve teknike, por jo përmbajtjen.

Ka nevojë urgjente për ndryshime të shpejta në ligjin 8410, datë 30.09.1998, i konceptuar të jetë i përafërt me ligjin e mëparshëm për telekomunikacionet i cili tashmë është shfuqizuar. Qeveria ka për qëllim të sigurojë se ligji për transmetimet televizive e ndjek ritmin e zhvillimeve teknologjike si dhe ecurinë drejt anëtarësimit në BE.

- Tashmë janë disa shembuj në Shqipëri ku transmetimet e radios dhe televizionit arrijnë konsumatorët nëpërmjet rrjeteve radio tokësore të cilat operojnë në brezat e spektrit të cilat KKRT nuk i rregullon, këto janë sistemet kabllore pa tela (*wireless*). Njëlloj, është e mundur që kanalet radio televizive të merren nëpërmjet Internetit nga konsumatorët të cilët përdorin aksesin me brez të gjerë. Në disa raste kjo mund të mos përdorohet radio spektrin por në raste të tjera aksesin me brez të gjerë mund të merret nëpërmjet radio teknologjisë (siç është *Wimax* ose *digital mobile*). Në shumë raste, pajisja kompjuterike fundore mund të lidhet në internet me brez të gjerë nëpërmjet hot spotëve ose ruterit të brendshëm *wireless*. Këto pjesë të spektrit gjithashtu nuk janë të rregulluara nga KKRT dhe nuk shihet nevoja për t'u rregulluar nga kjo e fundit. Në këto raste, përmbajtja (programi) do të rregullohet nga KKRT. Në ligjin e ri për transmetimet audiovizuale duhet të parashikohen klauzola për këtë qëllim.

- Bazuar në ligjin 9918 tashmë është ligjore që në Shqipëri të ndërtohet një infrastrukturë fikse e re për komunikime elektronike. Kjo do të thotë që rrjetet e reja me qëllim bartjen e televizionit kabllor mund të jenë duke u planifikuar ose ndërtuar. Sipas ligjit të sotëm, pronarët e këtyre rrjeteve nuk do të kenë nevojë për ndonjë autorizim tjetër për të ofruar akses në Interneti me brez të gjerë (dhe mund të ofrojnë sinjalin radio si dhe sinjal televiziv me shpejtësi më të madhe). Megjithatë, nëse ata dëshirojnë të ofrojnë televizionin kabllor tradicional, ata do të kenë nevojë për një licencë transmetimi dhe do të jenë subjekt i rregullimit të përmbajtjes nga KKRT.

- Teknologjitë të cilat mundësojnë konvergencën e transmetimeve radiotelevizive dhe komunikimeve private, si dhe të gjitha përfitimeve që e shoqërojnë këtë konvergencë, gjithashtu sjellin një rritje të hapësirës për krim dhe keqpërdorim, siç është mashtrimi on-line, keqpërdorimi i IPRs, shfrytëzimi i të miturve, spam etj. Qeveria ka për qëllim të zhvillojë një këshillim të gjerë, për të dhënë përgjigje ndaj këtyre çështjeve, gjithashtu, të marrë parasysh edhe zhvillimet në vendet e tjera. Kompanitë kryesore të cilat veprojnë në tregun shqiptar pritet të kontribuojnë me njohuritë e tyre të specializuara në gjetjen dhe zbatimin e zgjidhjeve.

KAPITULLI 5 TEKNOLOGJIA

5.1 Aksesit me brez të gjerë çfarë është?

Terminologjia “*broadband* me brez të gjerë” tani përdoret në kuptimin “e shpejtë” – në kuptim të transmetimit të të dhënave me shpejtësi të madhe. Në fillim të përdorimit të tij ky term përdoret për të përshkruar teknologjitë e reja të aksesit, të cilat mund të arrijnë shpejtësi shumë më të madhe sa me përdorimin e modemeve të cilat operojnë në linjat e thjeshta telefonike (zakonisht 56 Kb/s). Mundësia e transmetimit të të dhënave jashtë brezit zanor (speech band) do të thotë që linja telefonike mund të përdoret për të bërë telefonata në të njëjtën kohë kur përdoret Interneti. Prandaj kishte dy dobi: e shpejtë dhe e favorshme.

Aksesit në Internet me brez të gjerë sot është faktori kryesor i konkurrencës dhe rritjes ekonomike dhe sociale të një vendi. Të mund të marrësh dhe ndash informacionin me shpejtësi të madhe, rrit prodhimin, ndihmon tregun dhe mbështet rrugën drejt të resë. Aksesit në Internet me brez të gjerë ka një potencial të veçantë për të arritur pothuajse të gjitha fushat e jetës: mënyrën se si komunikojmë me njëri tjetrin, punën tonë, si i edukojmë fëmijët tanë, si argëtohem dhe si i shfrytëzojmë shërbimet mjekësore. Për t’i pasur të gjitha avantazhet e Internetit, konsumatorët duhet të jenë në gjendje të dërgojnë dhe të pranojnë të dhëna me shpejtësi të madhe. Kjo është ajo çfarë ofron aksesit me brez të gjerë.

Teknologjia e përdorur gjerësisht në vendet e BE-së, teknologjia DSL vazhdon të përmirësohet, duke ofruar tashmë shpejtësi të të dhënave prej 1 Mb/s deri 8 Mb/s¹³. Për shumë përdorues sot kjo është një shpejtësi e mjaftueshme dhe është një përmirësim i madh ndaj aksesit dial-up. Megjithatë, shpejtësia e procesorëve të kompjuterëve është rritur në mënyrë dramatike dhe shumë shërbime të reja janë shfaqur të cilat shfrytëzojnë akses me shpejtësi më të madhe¹⁴. Popullariteti i këtyre mundësive të reja do të thotë që llojet e shpejtësive të disponueshme me linjat e bakrit nëpërmjet DSL shpejt po bëhet kufizim për rritjen e mëtejshme të tregut në shërbimet e të dhënave me shpejtësi të madhe. Kjo është arsyeja pse shumë vende të BE-së tashmë kanë politika me theks të veçantë në “*new generation access*” që i referohet mënyrave të ndryshme të përdorimit të fibrave optike në vend të, ose bashkë me telat e bakrit.

Në të njëjtën kohë, tregu është duke e humbur homogjenitetin në kuptimin që jo të gjithë përdoruesit kanë nevojë ose dëshirojnë akses me shpejtësinë më të madhe të mundshme. Prandaj

13 ADSL2+ deri 24 Mbit/s, VDSL deri 100Mbit/s.

14 According to Cisco’s Visual Network Index report published in June 2008, on the nature of traffic transiting on the internet, 30% of the traffic is video type, compared to 5% in 2005, there is a slight increase of the so called Personal Content (such as Youtube). According to Cisco, in 2012, 50% of the traffic still consist of moving images.

aksesi me brez të gjerë nuk është zgjidhja e vetme dhe e pandryshueshme e cila do t'i sigurojë nevojat e të gjithëve. Në këtë aspekt, është e vështirë që aksesin me brez të gjerë të konsiderohet si një dobi elementare e standardizuar.

Rritja e penetrimit të shërbimeve me brez të gjerë është një nga objektivat kryesore të Qeverisë Shqiptare. Për këtë janë ndërmarrë disa nisma si p.sh “Shqipëria në moshën e internetit¹⁵”. Aksesin me brez të gjerë do të mundësojë shërbime për shoqëritë private dhe administratën publike si p.sh: shkarkimi i moduleve të ndryshme, dërgimi i dokumenteve, shfrytëzimi i telemjekësisë (e-Health), teleprezenca, telepuna etj.

Një listë e teknologjive kryesore, të cilat i ofrojnë konsumatorëve aksesin me brez të gjerë janë dhënë në shtojcën 2.

5.2 Aksesin me brez të gjerë në BE¹⁶

Aktualisht në BE janë më shumë se 100 milionë lidhje me brez të gjerë dhe rreth 85% të tyre ofrohen nëpërmjet teknologjisë DSL. Gjithashtu, do të ishte vlerësim pothuajse i saktë të thuhet se në BE çdo shtëpi që dëshiron një linjë telefonike tashmë e ka, dhe pothuajse të gjitha këto linja ofrohen me tela bakri. Pothuajse të gjitha shtëpitë në BE mund të kenë akses me brez të gjerë ose centralet telefonike lokale mund të pajisen për të ofruar brezin e gjerë. Prandaj pajisja me DSL nuk është një pengesë serioze.

Në këtë përfshihen edhe dy çështje:

Deri tani, roli i teknologjive të tjera me brez të gjerë (që nuk ofrohen me DSL) në BE ka qenë të stimulojnë operatorin inkumbent të ofrojë DSL më të shpejtë.

Ritmi i rritjes së penetrimit të brezit të gjerë tani përcaktohet kryesisht nga kërkesat, siç janë:

- sa janë të përballueshme këto shërbime,
- tërheqja e shërbimeve të mundësuar nëpërmjet brezit të gjerë, për shembull “double, triple and quad-play” paketa me tarifa të orientuara drejt përdoruesve,
- orari gjatë të cilit operatorët mund të ofrojnë shërbimin e kërkuar dhe
- ritmi me të cilin konsumatorët vendosin që dëshirojnë të blejnë atë.

Në shumicën e vendeve të BE-së këto janë gjërat e vetme të cilat mund të influencojnë shpejtësinë me të cilën penetrimi i Internetit me brez të gjerë do të arrijë të gjitha familjet të cilat e kërkojnë këtë shërbim. Tregu tashmë ka arritur pikën në të cilën autoritetet e BE-së e kanë përqëndruar vëmendjen në garantimin e shërbimit broadband në zona të vështira.

5.3 Aksesin me brez të gjerë në Shqipëri

Situata në Shqipëri është tërësisht e ndryshme pasi që ofrimi dhe kërkesa për Internet me brez të gjerë janë të paqarta. Për të gjitha llojet e aksesit në Internetin me brez të gjerë kërkesa varet pjesërisht nga penetrimi i kompjuterëve personalë, numri i të cilëve nuk është i lartë në Shqipëri. Gjithashtu, janë 40 linja bakri për çdo 100 familje prandaj për të arritur secilën prej tyre me DSL do të thotë pothuajse trefishimi i numrit të linjave të bakrit. Ka pak mundësi që kjo të mund të realizohet, dhe në çdo rast do të duhej shumë kohë që të arrihej (me ritmin aktual të përhapjes do të duheshin edhe 10 vite). Përveç kësaj, ka mundësi që teknologjia DSL të tejkalohet nga teknologji të tjera shumë kohë para ndërtimit të linjave të bakrit. Aktualisht sektori i televizionit kabllor është i vogël dhe furnizimi i mjaftueshëm i stacioneve televizive tokësore sugjerojnë që sistemet televizive kabllore mund mos shndërrohen në ofruesin kryesor të Internetit me brez të gjerë.

Në këto kushte, nëse Shqipëria do të arrijë disponueshmërinë e internetit me brez të gjerë, radio spektri duhet të ketë rol kryesor. Kjo është posaçërisht e dëshirueshme pasi që teknologjia radio mund të shfrytëzohet më shumë se sa teknologjitë fikse dhe shtimi i investimit përputhet me

15 Bazuar në këtë iniciativë, të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Shqipërisë do të kenë laborator kompjuterash dhe lidhje të internetit me brez të gjerë deri në vitin 2010.

16 “Aksesin në Internet me brez të gjerë në BE: situatë më 1 korrik 2009” COCOM paper 09-29, 18 nëntor 2009, shih: http://ec.europa.eu/information_society/eeurope/i2010/docs/interinstitutional/cocom_broadband_july09.pdf

rritjen e numrit të përdoruesve. Tashmë është shprehur interes nga operatorët për spektrin Wimax si dhe nga operatorët e lëvizshëm për akses në spektrin UMTS. Që të dyja janë të disponueshme dhe nuk ka arsye për vonesë për futjen e teknologjive të aksesit me brez të gjerë siç është 3G dhe Wimax.

Politikat e qeverisë janë që të lejohet dhe inkurajohet përdorimi i çdo teknologjie e cila do të sjelli një gamë më të gjerë të zgjedhjes, cilësi dhe çmime më të mira në treg.

KAPITULLI 6 VIZIONI I SHQIPËRISË PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 përfshin një pjesë e cila njihet rëndësinë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve (TIK) dhe i vendos vizionet e mëposhtme:

- Një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.

Më poshtë është vizioni marrë nga Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit:

Përparimi i Shqipërisë drejt një shoqërie të bazuar në njohuri nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm që çon drejt një shoqërie ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga telekomunikacionet dhe nga teknologjitë e informacionit me qëllim rritjen e nivelit të njohurisë, efikasitetit dhe transparencës në administratën publike.

Janë propozuar disa objektiva strategjike për arritjen e këtij vizioni. Ato mund të ndahen në masa të marra nga shteti për të përmirësuar mundësinë për investim nga investitorët privatë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimeve (posaçërisht në mënyrë që të ofrojnë shërbime) dhe veprime nga shteti për të rritur përdorimin e TIK nga institucionet shtetërore.

Qasja e përgjithshme e Strategjisë Kombëtare për TIK është ekuivalenti shqiptar i kuadrit të politikave të BE-së (i2010) për shoqërinë e informacionit dhe media për periudhën kohore deri në vitin 2010. i2010 është një paketë dinamike e iniciativave të drejtuara nga Komisioni Evropian në të cilat qeveritë inkurajohen të ndërtojnë mbi bazën e detyrueshme të Direktivave (kuadrit ligjor evropian). Shumica e iniciativave janë veprime vullnetare dhe përshpejtojnë zhvillimin e TIK, posaçërisht në sektorin publik. Gjithashtu, Komisioni Evropian ndjek një plan vjetor të veprimeve të cilat çojnë përpara zhvillimin e politikave në këtë sektor.

Shërbimet e komunikimeve elektronike janë baza themelore për të arritur vizionin e mësipërm. Vizioni i qeverisë për komunikimet elektronike është si vijon:

Brenda shtatë viteve të ardhshme, komunikimet elektronike do të ofrohen nga një mori operatorësh në një mjedis me konkurrencë efikase duke përdorur një gamë të gjerë teknologjish të cilat janë të lira të bartin të gjitha llojet e përmbajtjeve, qoftë private ose të transmetuara. Brezi i gjerë, me shpejtësi në rritje, do të jetë i disponueshëm për shumicën e familjeve, të cilat dëshirojnë ta kenë. Shqipëria do të jetë:

- larguar nga historia e investimeve të pamjaftueshme për linjat e bakrit.
- do të ketë shfrytëzuar situatën e saj unike.
- do të ketë arritur ekonominë e gamës duke siguruar disponueshmërinë e hapjes së qarkut lokal dhe që rrjetet transmetimit mbartin të gjitha llojet e komunikimeve private.
- do të ketë përfituar nga spektri i mjaftueshëm.

Instrumenti kryesor për të arritur këtë vizion është zbatimi i vazhdueshëm dhe i menjëhershëm i regjimit rregullator të krijuar me ligjin 9918 me theks të veçantë i aksesit me brez të gjerë. Qëllimi është të garantohet që operatorët e financuar të kenë mundësinë më të madhe për të pasur avantazh nga mundësitë e dhëna nga ligji. Ky është fokusi kryesor i këtij dokumenti të politikave i cili vendos propozime në gjashtë fushat kryesore ku veprimet nga agjencitë qeveritare

mund të ndihmojnë në suksesin e regjimit ose të ndihmojnë në largimin e pengesave të cilat hasen nga ata që kërkojnë të punojnë nën këtë regjim:

1. Radio spektri;
2. Shërbimi universal dhe të drejtat e përdoruesve;
3. Subvencionet dhe rregullat e konkurrencës;
4. Aksesin në pronën private ose publike;
5. Monitorimi dhe informimi i tregut;
6. Integrimi Europian.

Këto propozime dhe përjashtime do të shqyrtohen në kapitujt që vijojnë.

III - Propozime dhe pritshmëria

KAPITULLI 7 RADIO SPEKTRI

7.1 Administrimi efikas i spektrit

Administrimi efikas i spektrit të radio frekuencave ka dy përbërës kryesorë. I pari është plani kombëtar i radio frekuencave (PKRF) i përditësuar dhe i përgatitur në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Ky plan i cakton breza frekuencash shërbimeve të ndryshme të radio komunikacioneve dhe i mundëson Shqipërisë të përfitojë nga ekonomitë e shkallës, të cilat mund të përdorin radio pajisjet, të cilat prodhohen për treg më të gjerë ose treg global. Është përgjegjësi e ministrit për fushën e komunikimeve elektronike të përgatisë dhe mbajë PKRF në bashkëpunim me organet e tjera të interesuara të shtetit. Një PKRF i ri (2009) është përgatitur nga MPPTT në bashkëpunim me organet e interesuara shtetërore dhe është miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ky Plan është përgatitur në përputhje me tabelën europiane të ndarjes së frekuencave (ECA), e cila është në përputhje me radio rregulloret e përgatitura nga ITU për rajonet përkatëse.

Pjesa e dytë përbërëse është plani i përdorimit të spektrit të frekuencave, bazuar në PKRF, i cili i cakton frekuencat operatorëve individualë. Planet e përdorimit janë përgjegjësi e AKEP-it dhe KKRT-së.

Zhvillimi i mëtejshëm i disa shërbimeve të radio komunikacioneve varet nga vazhdimi i vënies në dispozicion të disa brezave, të cilët aktualisht janë të zënë nga përdorues të qeverisë. Është e rëndësishme të vazhdohet të jepet këto breza (disa të dhënë gjatë periudhave kohore të mëparshme) në përputhje me radio rregulloret e ITU-së, me tabelën europiane të spektrit të radio frekuencave dhe vendimin 676/2002/EC për kuadrin rregullator për politikën e radio spektrit në Bashkimin Evropian.

Është e rëndësishme të mos vendosen kosto të larta për përdorimin ekonomik të frekuencave. Këto kosto duhet të jenë të drejta dhe në përputhje me të ardhurat potenciale nga përdorimi i tyre. Parimi i tarifave të drejta për përdorimin e frekuencave është thelbësor për të quajturën “ekonomi wireless”.

7.2 Të rritet sasia e spektrit të disponueshëm

Synohet që të shkohet gradualisht drejt liberalizimit maksimal të përdorimit të frekuencave në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira të BE.

Parimi i përgjithshëm, i cili aplikohet në menaxhimin e spektrit është dhënia në përdorim në procedurë objektive transparente, jodiskriminuese që synojnë përdorimin efektiv dhe sa më eficient të spektrit duke shmangur interferencat.

Dhënia e spektrit do të jetë e kufizuar vetëm atëherë kur kërkesa për një brez është më e lartë se mundësia që ofrohet për të përmbushur këto kërkesa.

Nëse kërkesa për spektër tejkalon ofertën, duhet të përdoret një procedurë tenderi ose konkurruese.

Janë një numër brezash të frekuencave ,të cilët duhet të bëhen të disponueshëm sa më shpejt të jetë e mundur dhe mundësisht bazuar në parimin e asnjësisë teknologjike. Kapacitete të tjera mund të krijohen duke hequr kufizimet për përdorim për të mundësuar një liri më të madhe për të përdorur breza të veçantë. Duhet bërë përpjekje që disa breza të jenë neutralë ndaj teknologjisë p.sh. 900MHz, 1.8GHz, 2.6GHz dhe 3.5GHz. Bazuar në përvojën e vendeve e tjera ,si dhe duke marrë parasysh efikasitetin e pajisjeve moderne, AKEP do të fillojë një këshillim publik për *refarming* e brezave 900MHz dhe 1800 MHz në mënyrë që të lejohet përdorimi i teknologjive më të reja (UMTS, LTE) ,të cilat kërkojnë blloqe prej 5MHz në vend të kanaleve prej 200MHz të përdorur aktualisht për GSM. Plani kombëtar i frekuencave tashmë parashikon këtë zhvillim.

Rritja e përdorimit të spektrit do të sjellë një nevojë më të madhe për menaxhim dhe bashkërendim ndërmjet AKEP-it, KKRT-së dhe qeverisë. Kjo sfidë nuk do të jetë vetëm lidhur me çështjen e lëshimit të autorizimeve. Agjencitë rregullatore duhet gjithashtu t'i përgjigjen mundësive më të mëdha për interferenca, keqpërdorimit, si dhe problemeve të tjera me cilësinë. AKEP-i dhe KKRT-ja duhet të kenë burime të mjaftueshme për të kryer këtë punë.

7.3 Kalimi në televizionin digjital

Ligji nr. 9742, datë 28.5.2007“Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë“ për transmetimin digjital rregullon tranzicionin në televizionin digjital. Kur ky tranzicion të ketë përfunduar do të lindin mundësi që spektri i liruar i televizionit të vjetër analog të shpërndahet te përdoruesit e rinj. Megjithatë, përdorimi aktual i spektrit për televizion në Shqipëri është i veçantë dhe për ndryshim nga vendet e tjera i gjithë brezi 470 deri 862 MHz mund të përdoret në mënyrë efikase për televizionin digjital.

Diskutimet në nivelin e BE-së marrin parasysh mundësinë për të përdorur pjesë nga ky brez për shërbime të reja në gjithë Evropën. ITU i ka caktuar nën-brezi 790 deri 862 MHz shërbimeve të lëvizshme. Shqipëria do të monitorojë këto zhvillime nga afër dhe do t'i marrë parasysh gjatë kalimit në televizionin digjital.

KAPITULLI 8

SHËRBIMI UNIVERSAL DHE TË DREJTAT E PËRDORUESVE

8.1 Përcaktimi i “shërbimit universal

Në lidhje me shërbimin telefonik, termi “shërbim universal” është përdorur një kohë të gjatë në vendet e zhvilluara (duke filluar në SHBA) për të ju referuar realizimit të objektivit që çdonjëri që dëshiron telefon duhet të ketë mundësinë ta ketë atë. Në kohën e monopoleve, politikëbërësit e vendosën këtë objektiv për të arsytuar çmimet e çrregulluara dhe monopolet në të cilat ata mbështeteshin. Prandaj synohej që të sigurohej akses i shërbimit telefonik për të gjithë qytetarët, edhe nëse ofrimi i këtij shërbimi mund të mos sjellë përfitime në disa zona gjeografike ose për disa familje. Pritej që operatorët monopol të kompensojnë humbjet në një zonë me përfitime nga zona tjetër. Në disa vende europiane, kryesisht në Evropën veriore dhe perëndimore, këto lloje të ndër-subvencionimeve brenda monopolit çuan drejt një penetrimi të lartë të shërbimit të telefonisë fikse. Në vendet e tjera përfshirë dhe Shqipërinë mungesa e këtyre ndër- subvencioneve ka sjellë një penetrim jo të lartë të shërbimit telefonik nëpërmjet linjave fikse.

Duke lejuar konkurrencën në treg parandalohen çmimet e çekuilibruara ndërsa kërkoheshin qasje të reja nëse kompensimi për humbjet do të mbahej nën kontroll. Prandaj, në BE domethënia e shërbimit universal është përcaktuar në mënyrë të tillë në ligjet e reja, në kuadrin ligjor evropian (acquis), që shërbimi universal nuk është thjesht një ambicie udhërrëfyese për politikë-bërësit por një paket e detyrimeve ligjore të cilat qeveritë duhet ta plotësojnë. Detyrimet nuk mundësojnë vetëm që shërbimi telefonik të jetë i disponueshëm në çdo vend. Disa shërbime të tjera bazë gjithashtu janë të nevojshme (siç është mundësia për të thirrur shërbimet emergjente pa pagesë). Veçanërisht, ligji kërkon që të drejtat e përdoruesve të mbrohen në mënyra të përcaktuara.

8.2 Shërbimet e ofruara në vendet tjera

Lidhur me koston e ofrimit të shërbimeve bazë dhe të përballueshme në çdo vend, përcaktimi i shërbimit universal është disenjuar në mënyrë të tillë që të garantojë që këto vende të mund të mbrojnë nivelin e lartë të penetrimit tashmë të arritur në shtetet e BE-së, në mënyrë që ato të mos bëhen të papërballueshme si shkak i liberalizimit. Detyrimet e sakta janë vendosur në direktivën e shërbimit universal dhe kanë dy qëllime kryesore: e para, të sigurojnë që paketa themelore e shërbimeve të vazhdojë të ofrohet dhe e dyta, të sigurojnë që rregullatorët nuk e çekuilibrojnë tregun nga masat e ndërmarra për të financuar ofrimin e tyre.

Përmbledhje:

Një paketë e caktuar e shërbimeve themelore duhet të bëhet e disponueshme.

Nëse ofrimi i këtyre shërbimeve rezulton në një kosto neto e cila do të ishte e padrejtë për ofruesit e shërbimit, atëherë kjo kosto duhet të kompensohet nga fondi i shërbimit universal ose nga fonde publike (taksa paguesit). Kostoja neto është llogaritur nga rregullatorët dhe merr parasysh çdo përfitim të paprekshëm që rrjedh te pronarët.

Një detyrim neutral konkurrues për t'u paguar në fondin e shërbimit universal, vetëm për këtë qëllim, mund të vendoset mbi operatorët.

Shërbimet tashmë janë të përcaktuara siç është paraqitur në shtojcën 3, e cila është marrë nga nenet 3-7 të direktivës.

Sipas ligjit nr. 9918 , AKEP-i ka për detyrë të përcaktojë një ose më shumë ofrues të shërbimit universal, edhe pse sipas ligjit të BE-së, kjo mund të bëhet vetëm nëse është e domosdoshme, nëse paketa e shërbimeve bazë nuk do të ofrohej në një mënyrë tjetër. Aksesit në një vendndodhje fikse mund të ofrohet duke përdorur teknologjinë e lëvizshme dhe mund të ketë ofrues të tjerë të shërbimit universal në rajone të ndryshme të vendit ose për shërbime të ndryshme nga paketa bazë.

8.3 Mbrojtja e të drejtave të përdoruesve

Përveç mbrojtjes, e cila i ofrohet përdoruesve sipas ligjit të përgjithshëm për konsumatorët, mbrojtja e ofruar me ligjin nr. 9918 duke transpozuar direktivat e BE-së është një tjetër shtesë. Për shërbimet e komunikimeve elektronike, përdoruesit kanë të drejtë të marrin një kontratë që përfshin detajet specifike, në veçanti lidhur me tarifat dhe kostot, me mundësi për të anuluar kontratën nëse ofruesi i ndryshon kushtet. Duhet gjithashtu të ketë mbrojtje nga ndërprerja e pa paralajmëruar e shërbimit, dhe në veçanti në rast të mosmarrëveshjeve për faturat e larta për shërbimet me vlerë të shtuar, përdoruesit duhet të vazhdojnë të kenë akses në shërbimet bazë telefonike duke pritur zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjithashtu duhet të jetë e disponueshme zgjidhja e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës me çmim të ulët. Operatorët të cilët hasin në vështirësi në këtë sektor, duhet të bashkëpunojnë me AKEP-in dhe aktorët e tjerë në industri në mënyrë që të garantojnë që praktikat e tyre tregtare janë në përputhje me kërkesat për mbrojtjen ligjore dhe të gjejnë zgjidhje kur është e nevojshme.

AKEP-i duhet të monitorojë situatën e konsumatorëve lidhur me përdorimin e shërbimeve telefonike të mundshme për publikun dhe në veçanti nëse tarifat janë të përballueshme. Përballueshmëria e çmimeve e shërbimeve telefonike nuk është thjesht një çështje e faturave të zakonshme në raport me të ardhurat, është e lidhur me informacionin të cilin përdoruesit e marrin mbi koston e përdorimit të telefonit si dhe mbi koston relative të përdorimit të telefonit krahasuar me shërbimet e tjera, dhe gjithashtu lidhur me mundësinë për të kontrolluar shpenzimet. AKEP-i gjithashtu duhet të monitorojë cilësinë e realizuar të shërbimeve të operatorëve ,të cilët i ofrojnë përdoruesve shërbime publike të telefonisë fikse.

8.4 Konkluzione

Është e qartë se prezantimi i telefonisë së lëvizshme në dy dekadat e fundit ka ndryshuar plotësisht vendin e telefonisë fikse në plotësimin e nevojave të shoqërisë. Lidhur me rritjen e penetrimit të telefonisë së lëvizshme, penetrimi i telefonisë fikse në familje tashmë është në rënie në shumicën e vendeve të BE-së, madje edhe në shtetet anëtare të reja ku penetrimi nuk ka qenë kurrë

shumë i lartë. Rritja e kërkesave për internetin me brez të gjerë është një faktor, i cili mund të ndalojë ose kthejë prapa këtë tendencë, por është e qartë se tregu tashmë është në tranzicion dhe mund të shfaqet nevoja për të ndryshuar të gjitha rregullat e BE-së për të siguruar disponueshmërinë universale të askesit në komunikacione si përgjigje ndaj situatës.

Një çështje thelbësore e cila duhet të trajtohet nga AKEP-i është shkalla në të cilën tregu i lirë mund të ofrojë paketën e shërbimeve bazë sa herë të jetë e nevojshme. Aspekti i përballueshmërisë së çmimeve është potencialisht shumë problematike posaçërisht në pjesë të caktuara të vendit. Rezultati i studimit të mëhershëm do të duhet të merret parasysh, së bashku me dëshmitë e nivelit aktual të lartë të shpenzimit për shërbimet e lëvizshme.

Në raportin vjetor, AKEP vendos planin për të siguruar zbatueshmërinë me rregullat e tanishme siç shprehet ligji nr. 9918. Qeveria mirëpret këto qëllime dhe pret që ministria, AKEP-i dhe agjencitë e tjera të interesuara të mbajnë këtë çështje në rishikim të vazhdueshëm për të siguruar përfitime maksimale për përdoruesit në Shqipëri.

KAPITULLI 9 SUBVENCIONET DHE RREGULLAT E KONKURENCËS

Rregullat e konkurrencës së traktateve të BE-së (nenet 81-89 me numrat e marra nga traktati i Lisbonës 101-109) e ndalojnë marrjen e masave rregullatore ,të cilat mund të çrregullojnë një treg tashmë konkurrues. Këto rregulla janë gjithashtu të vlefshme edhe në Shqipëri nëpërmjet marrëveshjes së ndërmjetme me BE-në. Ka arsye për këto rregulla, pasi ato garantojnë investitorët që janë në dijeni se përpjekjet e tyre për të ndërtuar një biznes duke investuar në treg nuk do të pengohen (ndoshta edhe aksidentalisht) nga qeveria ose veprimet rregullatore.

Direktiva e shërbimit universal vendos disa rregulla të tjera shtesë lidhur me çrregullimin e çmimeve të cilat përcaktojnë se nëse këto rregulla zbatohen, krijimi i fondit të shërbimit universal nuk do të konsiderohet si një ndërhyrje ilegale në tregun konkurrues.

Në çdo ndërhyrje tjetër në treg (për shembull, nëse qeveria ose një bashki vendos të shpenzojë paratë e taksapaguesve për të krijuar një rrjet fibrash për t'i ofruar shërbime të tjerëve) që mund të ndikojë në tregun konkurrues, propozimi duhet të projektohet me kujdes dhe të zbatohet në mënyrë të tillë që të mos çrregullojë konkurrencën. Në BE, përgjegjësia për të vlerësuar propozimet për zbatueshmërinë bie mbi Komisionin. Logjikisht, në Shqipëri, kjo detyrë bie mbi Autoritetin e Konkurrencës dhe Komisionit e Ndihmës Shtetërore(METE).

Disa vende të BE-së, gjatë viteve të fundit, kanë propozuar veprime si “asistencë nga shteti“ dhe shumica janë pranuar nga Komisioni, i cili gjithashtu ka publikuar udhëzime lidhur me vlerësimin e këtyre projekteve dhe si rrjedhojë, si duhet të organizohen ato për të shmangur çrregullimin e konkurrencës. Këto udhëzime janë të vlefshme nëse fondet derdhen nga burime qeveritare ose nga BE-ja. Udhëzimet gjithashtu do të ishin të përshtatshme për përdorimin e fondeve të derdhura nga taksat e sektorit që nuk arsyetohet me ligjin nr.9918 (i cili transpozon direktivën e shërbimit universal) pasi që kjo do të konsiderohej thjesht si një lloj i veçantë takse.

Ligji nr. 9918 në mënyrë të qartë ndalon përdorimin e fondit të shërbimit universal për çfarëdo qëllimi tjetër, përveç financimit të shërbimit universal siç është përcaktuar aktualisht. Kjo do të thotë se vjelja e taksave të sektorit për qëllime të tjera kërkon bisedime me operatorët ose ndryshimin të ligjit.

Qeveria ka pritshmëri të lartë për efektet e liberalizimit me ligjin nr.9918 dhe dëshiron të shohë në çfarë mase hyrësit e rinj në treg dhe investimet private rriten me liritë e reja, të cilat janë tashmë të disponueshme dhe të cilat do të bëhen të disponueshme pasi brezat e rinj të spektrit të jenë ofruar në treg.

Qeveria pret të shohë progres, por është e vetëdijshme që dhënia e çdo indikacioni që skemat për përkrahjen e investimeve me fonde publike janë duke u marrë parasysh, mund të shkaktojë vonesa dhe gjithashtu mund të inkurajojë vendime lidhur me investimet private. Në

mënyrë që të shmangen pasoja të paqëllimshme, Qeveria dëshiron t'i bëjë të qarta qëllimet e saja si vijon:

- Deri në fund të 2011, fondet e qeverisë për promovimin e aksesit me brez të gjerë do të drejtohen kryesisht drejt organeve publike për të prokuruar shërbime të të dhënave me shpejtësi të madhe për përdorimin e tyre. Këto fonde do të rezervohen për këtë qëllim dhe shërbimet duhet të prokurohen në mënyrë konkurruese dhe për kontrata me kohëzgjatje të kufizuar. Çdo skemë e financuar nga qeveria që ka për qëllim promovimin e blerjes së aksesit me brez të gjerë nga individë ose familje nuk do të diskriminojë ndërmjet ofruesve të teknologjive. Këto njihen si ndërhyrje në bazë të kërkesës dhe duhet të jenë të paanshëm ndaj konkurrencës.

- Ndërkohë, agjencitë qeveritare do të këshillohen me industrinë lidhur me dëshirën për të zgjeruar stimujt e taksave për investime të cilat ofrojnë akses me brez të gjerë.

- Në marrjen parasysh të mundësisë së përdorimit të fondeve publike për ofrimin e investimeve, qeveria do të këshillohet gjerësisht dhe do të sigurojë që çdo skemë i zbaton udhëzimet e BE-së.

- Qeveria nuk kundërshton në parim mundësinë e investimit nëpërmjet projekteve të përbashkëta, por këto projekte duhet të jenë në përputhje me ligjin për konkurrencën dhe t'i nënshtrohen, nëse është e nevojshme, masave të nevojshme rregullatore p.sh. detyrimit për t'i ofruar akses të gjithë përdoruesve të rinj me kushte jodiskriminuese.

- Siç është përcaktuar në pjesën 1 më sipër, qeveria beson se kuadri rregullator i BE-së i transpozuar në ligjin shqiptar ofron çdo fleksibilitet të nevojshëm për të inkurajuar investitorët. Prandaj nuk konsideron se ndonjë”pushim rregullator“duhet të parashikohet me ligj.

KAPITULLI 10

AKSESI NË PRONËN PUBLIKE DHE PRIVATE

Përhapja e infrastrukturës së rrjeteve të komunikimeve elektronike është thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe ligji nr. 9918 ka dispozitë të veçantë për ta lehtësuar aksesin në territore dhe prona të tjera shtetërore operatorëve të rrjeteve (duke përfshirë ndërtesa, uzina nëntokësore, rrugë, liqene, pyje etj.) për të ndërtuar infrastrukturë siç janë tubacionet nëntokësore dhe shtylla ,si dhe të mirëmbahen pajisjet e instaluara të komunikacioneve. Subjekt i masave mbrojtëse të përshtatshme, ligji gjithashtu ofron mënyra për të detyruar aksesin në pronë private në kushte kur kjo është e rëndësishme thelbësore. Në mënyrë që të mundësohet akses dhe të reduktohet ndikimi në mjedis, ligji 9918 gjithashtu inkurajon fuqishëm përdorimin e përbashkët të infrastrukturës kur kjo është e mundur teknikisht.

Natyrisht, në shumë raste, mund të pritet nga pronari përgjegjës i pronës të ketë interes të përbashkët dhe në këtë mënyrë të garantojë disponueshmërinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Do të ishte e pazakonshme nëse masat detyruese do të përdreshin shpesh. Sidoqoftë, masat janë vendosur për rastet e rralla kur detyrimi është i nevojshëm.

Jo shumë ndërtesa ekzistuese janë të pajisura me kabllot e dhura, tubacionet dhe hapësirat për terminimin e kabllave, prandaj aplikimi i rregullave të dhura do të ishte një ndihmë në uljen e pengesave. Për ndërtesat e reja, rregullat e detyruara të ndërtimit duhet të kërkojnë të paktën, tubacione të përshtatshme si dhe pika të aksesit .të cilat çojnë deri te tubacionet nëntokësore të jashtme.

10.1 Facilitetet shoqëruese

Titulli i plotë i direktivës për aksesin, 2002/19/EC është “Direktiva për aksesin në, dhe interkonjeksionin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese”. Termi “facilitete shoqëruese” ka për qëllim të qartësojë që detyrimi për të ofruar akses mund të shtrihet në çdo gjë që është e nevojshme për interkonjeksionin e rrjeteve për të funksionuar siç duhet. Ndërmjet të tjerave, kjo mbulon aksesin në infrastrukturë fizike duke përfshirë ndërtesa, tubacione dhe shtylla. Mbi këtë bazë gjithëpërfshirëse përdorimi i përbashkët i ndërtesave të një operatori, tubacioneve dhe shtyllave mund të detyrohet nga rregullatorët kur kjo të jetë e arsyeshme.

Në shumë raste aksesi në këto lloje facilitetesh nuk ka rezultuar si problematik, por në raste të veçanta, tubacionet, ndërtesat ose shtyllat në fjalë nuk janë pronë e operatorit inkumbent (edhe pse ky operator mund të jetë duke i përdorur ato) dhe kjo mund të paraqesë pengesë për zbatimin e duhur dhe marrjen e masave rregullatore nëpërmjet regjimit rregullator, pasi shfuqizohen fuqitë zbatuese në përgjegjësi të AKEP-it. Qeveria e konsideron se është e detyruar të bëjë çfarëdo ndryshime të jetë e nevojshme në ligje dhe rregullore të cilat administrojnë përdorimin e pronës publike dhe private për të siguruar që pengesat për zhvillimin e tregut janë zvogëluar.

Në shumë raste të shfaqjes së vështirësive përfshihen tubacionet nëntokësore të cilat zakonisht janë në pronësi të shtetit ose bashkisë.

10.2 Facilitetet e tjera në territore publike

Çështja e aksesit në facilitetet në territore publike, ku aksesi kontrollohet nga autoritetet publike ose ku është e nevojshme marrja e lejes nga autoritetet publike, është e rëndësishme për suksesin e liberalizimit. Hyrësit e rinj në treg duhet të kenë mundësinë të marrin çdo leje të nevojshme pa vonesa ose kosto. Problemet mund të lindin nëse rregullat nuk janë të sakta ose të dobishme, nëse rregullat nuk ndiqen ose nuk zbatohen siç duhet ose nëse rregullat thjesht nuk njihen ose nuk kuptohen nga palët e përfshira.

Situata në Shqipëri nuk është tërësisht e kënaqshme. Hyrësit e rinj nuk e gjejnë cilësinë e njëjtë të bashkëpunimit të nevojshëm në të gjitha qytetet. Disa të dhëna sugjerojnë që një sasi e madhe e infrastrukturës së jashtme (tubacionet nëntokësore, sistemet kablore dhe antenat) janë instaluar ose përdorur me procedura jo të rregullta. Në një mënyrë kjo është një dëshmi pozitive e bizneseve energjike të cilat dëshirojnë ti shërbejnë konsumatorëve të tyre. Megjithatë, instalimi jo i rregullt lë shërbimet në këtë sektor të pasigurta, me mundësi për tu çrregulluar dhe gjithashtu mund të krijojë probleme të tjera siç është çrregullimi i mjedisit dhe ndërhyrje tek përdoruesit e tjerë.

Qeveria dëshiron të përmirësojë praktikën dhe rregullat mbi përdorimin e territoreve publike dhe ndërtesave për qëllime të komunikimeve elektronike në mënyrë që përfitimet të mund të ndjehen, të jenë më të shpejta dhe më të sigurta. Prandaj, qeveria propozon të bëjë një analizë të situatës, në këshillim me AKEP-in, industrinë, ministritë përkatëse, autoritetet vendore dhe palët e tjera të interesuara private ose publike për të vendosur masat e nevojshme për përmirësimin e situatës.

10.3 Aksesi në pronën private

Liberalizimi i sektorit të komunikimeve elektronike ka çuar drejt mundësive që në zonat e ndërtuara kohët e fundit (siç janë bizneset e reja ose zonat industriale dhe ato rezidenciale) aksesi për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve të mund të kontrollohet nga pronari i truallit ose i ndërtesës i cili vetë është ofrues i shërbimeve të komunikimeve elektronike. Ka më shumë mundësi që pronari i truallit të mund të kërkojë të negociojë një kontratë ekskluzive me një ofrues të vetëm të shërbimeve nëpërmjet linjës kablore. Teorikisht, kjo mund të çojë drejt krijimit të një monopoli të ri lokal në ofrimin e shërbimeve nëpërmjet linjës kablore dhe në këtë mënyrë mund të pengojë qëllimet e ligjit 9918.

Qeveria dëshiron të garantojë se të drejtat e pronës private nuk përdoren në mënyrë të tillë që do të ndikonte negativisht në zhvillimin e tregut të shërbimeve të komunikimit elektronik.

Me urdhër nr.172, datë 23.11.2009 të Kryeministrit është ngritur një grup ndërministror pune "Përgjegjës për përgatitjen dhe hartimin e kuadrit ligjor, për realizimin e infrastrukturës së rrjetit të komunikimeve elektronike". Gjithashtu është ngritur, një grup i punës i udhëhequr nga Ministri i Inovacioni dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit me urdhër nr.10, datë 8.3.2010, i cili do të trajtojë problemet e lidhura me investimet në infrastrukturë, duke përfshirë të drejtën e pronës publike dhe private, si dhe një studim të fizibilitetit të rrjetit kurrizor kombëtar. Ky grup aktualisht po ekzaminon zgjidhjet, të cilat janë përdorur në vendet tjera lidhur me këtë problem dhe do të punojë në konsultim me ministritë përkatëse, operatorët, AKEP dhe palët e tjera me interes për të implementuar masat rregullatore.

KAPITULLI 11
MONITORIMI, INFORMIMI DHE INTEGRIMI NË BE

Ligji nr. 9918 parashikon se kontribuuesit më të rëndësishëm të suksesit të sektorit të komunikimeve elektronike në Shqipëri janë operatorët e financuar privatisht ,të cilët veprojnë në një treg konkurrues. Brenda këtij konteksti, përgjegjësia për zhvillimin dhe zbatimin ex ante të rregullave bie mbi AKEP-in dhe KKRT-në të cilët punojnë në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës ,i cili është përgjegjës për kuadrin e përgjithshëm të rregullave ex post të cilat aplikohen në të gjithë sektorët. Roli i qeverisë, i veçantë nga ai i këtyre agjencive të pavarura, është më i kufizuar se sa në të kaluarën por ruan kompetenca të caktuara. Për më shumë, qeveria mbetet përgjegjëse për ndërmarrjen e çfarëdo veprimi të nevojshëm nëse për arsye të paparashikueshme, rregullimet e krijuara me ligj nuk funksionojnë në mënyrë efikase.

11.1 Organizimet ekzistuese monitoruese

Në kontekst të veçantë të kuadrin ligjor evropian për komunikimet elektronike dhe përgatitjeve drejt anëtarësimit në BE, Komisioni Evropian i ka dhënë një kontratë *Cullen International* –”Mbikëqyrja e zhvillimeve rregullatore dhe të tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të shoqërisë së informacionit në vendet në zgjerim“. Kjo është një detyrë trivjeçare për të prodhuar një seri raportesh shumë të detajuara lidhur me një grup vendesh duke përfshirë edhe Shqipërinë. Raporti i dytë është publikuar me 1 qershor 2008 dhe është në adresën si vijon:

<http://www.culleninternational.com/documents/cullen/cipublic/studies/studiesprogress.cfm>

Arsyeja për këto raporte është se Komisioni Evropian ka nevojë të krijojë një mendim të mirë informuar rreth situatës në këto vende. Raporti për Shqipërinë, i cili përgatitet nga *Cullen International* në konsultim me ministrinë e Inovacioni,Teknologjisë së Informacioni dhe Komunikimit dhe AKEP-in janë të ngjashme në fushëveprim me raportet e zbatueshmërisë ,të cilat vetë stafi i Komisionit Evropian i përgatit në vendet e BE-së. Prandaj këto raporte janë të rëndësishme për dialogun e rregullt ndërmjet qeverisë dhe Komisionit Evropian ,i cili zë vend nën traktatin e marrëdhënieve të Shqipërisë me BE-në. Gjithashtu, sa i përket këtij sektori, këto raporte kontribuojnë në raportin vjetor të ecurisë të Komisionit Evropian.

Raportet kanë një dobi tjetër pasi që lejojnë krahasimin me vendet e tjera në rajon dhe me vendet e BE-së. Qëllimet e qeverisë janë t'i projektojnë veprimet e tyre në këtë fushë mbi faktet e tregut, siç ato shfaqen duke përfshirë efikasitetin e dukshëm të regjimit të ri rregullator në arritjen e qëllimeve. Raportimi vjetor të cilin AKEP-i detyrohet ta bëjë para Kuvendit sipas nenit 9 të ligjit nr.9918 do të jetë një arritje e rëndësishme në punën e qeverisë për të realizuar qëllimet e nevojshme.

11.2 Masat kombëtare për të informuar tregun

Është e rëndësishme që vendimet e ministrisë, AKEP-it dhe agjencive të tjera janë të bazuara, sa më shumë të jetë e mundur, në fakte. Që të dyja, ministria dhe AKEP-i kanë fuqi të grumbullojnë informacion sa më shumë të jetë e mundur për faktet e rastit. Qeveria pret që ministria dhe AKEP-i:

- Të publikojnë raporte të herë pas hershme me interes publik mbi gjendjen e tregut dhe zhvillimit të tij.
- Të bashkëpunojë në organizimin e konferencave publike vjetore për të interesuarit në komunikime elektronike.

Qëllimi është të inkurajohet këshillimi publik, të nxitet një njohje më e madhe e vlerave të shpërndarjes së menjëhershme të informacionit dhe dëshirës së shoqërisë shqiptare dhe palëve të interesuara për tu informuar nga kontakti i drejtpërdrejtë me sipërmarrësit nga të cilët edhe varet suksesi i këtij sektori.

11.3 Të ndiqet evolucioni i regjimit rregullator të BE-së

Shqipëria ka për qëllim që sa më shumë të jetë e mundur të sigurojë akses në mekanizmat e BE-së për zbatimin dhe zhvillimin e regjimit rregullator për komunikimet elektronike. Qeveria, nëpërmjet Ministrisë të Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në bashkëpunim me AKEP-in dhe agjencitë e tjera qeveritare, do të mbikëqyrë evolucionin e përditshëm të politikave të BE-së për komunikimet elektronike dhe spektrin nëpërmjet publikimit të seancave të komiteteve dhe grupeve përkatëse dhe rezultateve të studimeve të publikuara¹⁷. Që të promovojë veprime të përbashkëta, qeveria ka për qëllim që prodhimi i raporteve të shkurtra të publikuara të sinkronizohet me ritmin e dialogut në fushën e komunikimeve elektronike që zë vend nën traktatin që i vendos marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së.

SHTOJCA 1

SEKTORI I TRANSMETIMEVE RADIO TELEVIZIVE

1. Televizionet tokësore kombëtare

Televizionet kombëtare janë të përbëra nga:

1.1 Televizionet tokësore publike;

1.2 Televizionet tokësore private;

1.1 Televizioni tokësor publik.

Rrjeti publik tokësor drejtohet nga Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)

Televizionet publike janë si më poshtë:

-1 rrjet kombëtar të televizionit tokësor (analog): TVSH

-3 rrjetet rajonale të televizionit tokësor (teknologji analoge): TV Gjirokastra, TV Korça dhe TV Shkodra.

Programet

Televizioni publik transmeton një program televiziv 24 orësh. Ende mungon programi i dytë i përcaktuar me ligjin nr.8410 “Për televizionet publike dhe private në Republikën e Shqipërisë” (Me perspektivën e kalimit në transmetimet digjitale, investimet për të ndërtaur një tjetër rrjet analog tokësor konsiderohen të papërshtatshme).

Transmetimi

Aktualisht, programet e televizionit publik transmetohen nëpërmjet rrjetit televiziv analog tokësor në brezat e frekuencave VHF dhe UHF, të cilat mbulojnë së paku të gjitha pjesët e banueshme të vendit (mbi 73% të territorit). Për këtë qëllim janë përdorur stacione transmetues të instaluar në mbi 10 pika transmetimi dhe rreth 250 përsëritës. Sinjali nga studiot në stacionet transmetuese dërgohet nëpërmjet lidhjeve mikrovalore. Kostot e shpërndarjes së sinjalit vlerësohen të jenë rreth 29% e buxhetit total vjetor me një personel prej 250 personash, derisa kostot e shpërndarjes së sinjalit të kompanive transmetuese Evropiane janë më pak se 10% të buxhetit total vjetor.

Në përgjithësi, infrastruktura teknike e RTSH-së është e varfër. Furnizimi me energji në vend nuk është i qëndrueshëm.

1.2 Televizionet tokësore private

- 2 rrjete të përgjithshme të televizionit kombëtar: Klan TV dhe Top Channel

- 73 rrjete rajonale ose lokale të televizionit analog tokësor (të cilat mbulojnë 1 qytet me deri 4 rrethe). 3 rrjete lokale ofrojnë vetëm lajme (News 24, Top News, Ora News).

Tabela më poshtë paraqet mbulimin e territorit shqiptar të realizuar çdo vit nga rrjetet kombëtare të televizionit analog tokësor (publik dhe privat), krahasuar me kushtet e mbulimit të licencës.

¹⁷ Para se Shqipëria të marrë statusin e observuesit, në komisionet dhe grupet përkatëse të BE-së do të thotë se duhet të punohet nga materialet e publikuara nga burime zyrtare të BE-së ose me materiale të prodhuara nga shërbime raportuese tregtare, për të cilat është i nevojshëm abonimi

Vitet	Përshkrimi	TVSH	R. Tirana	TVA	TV Klan	R.T. Alb	Radio +2	Top Channel
		Publik	Publik	Viti Licen. 2001	Viti Licen. 2001	Viti Licen. 2001	Viti Licen.. 2002	Viti Licen.. 2008
2002	Viti i funksionimit	----	----	2	2	2	-----	-----
	Kushtet e mbulimit të licencës (%)	----	-----	7.33	7.33	28.85	-----	-----
	Mbulimi aktual (%)	73.31	80.54	27.39	40.91	87.22	-----	-----
2003	Viti i funksionimit	----	-----	3	3	3	1	-----
	Kushtet e mbulimit të licencës (%)	----	-----	26.4	26.4	55.76	10.11	-----
	Mbulimi aktual (%)	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	-----
2004	Viti i funksionimit	-----	-----	4	4	4	2	
	Kushtet e mbulimit të licencës (%)	----	-----	46.97	46.97	72.69	28.87	-----
	Mbulimi aktual (%)	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	-----
2005	Viti i funksionimit	----	-----	5	5	5	3	
	Kushtet e mbulimit të licencës (%)	----	-----	62.09	62.09	94.4	55.76	-----
	Mbulimi aktual (%)	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	-----
2006	Viti i funksionimit	----	-----	6	6	6	4	
	Kushtet e mbulimit të licencës (%)	----	-----	75.71	75.71	90	72.68	-----
	Mbulimi aktual (%)	73.31	80.54	30.1	44.53	87.22	72.64	-----
2007	Viti i funksionimit	----	-----	7	7	0	5	-----
	Kushtet e mbulimit të licencës (%)	----	-----	86.86	86.86	90	94.4	-----
	Mbulimi aktual (%)	73.31	80.54	30.1	44.53	87.22	72.64	-----
2008	Viti i funksionimit	----	-----	8	8	1	0	1
	Kushtet e mbulimit të licencës (%)	----	-----	90	90	90	90	50
	Mbulimi aktual (%)	73.31	80.54	40.8	69.8	87.22	72.64	62.1

1.3 Transmetimi digjital i deritanishëm

Televizioni digjital tokësor dhe satelitor tashmë është realitet në Shqipëri.

1. DIGITALB

Qysh nga korriku i vitit 2004, kompania DIGITALB i ofron shumicës së popullsisë një paketë të programeve digjitale.

Në fakt, DIGITALB-i përdor 4 frekuenca analoge mbi pothuajse 1/3 e territorit (në një rrjetë të vetëm të frekuencave SFN) për të transmetuar 38 programe (18 falas dhe 20 me pagesë) nga të cilat 15 prodhohen nga DIGITALB. Teknikisht, DIGITALB-i transmeton 9 deri 10 programe multiplekse (të standardit DVB-T), për kanal frekuencë analoge, kur numri i programeve për kanal, për të siguruar një cilësi standarde, është përafërsisht 5 deri 7 programe. Ky numër i lartë programesh për kanal është caktuar për të siguruar një shfrytëzim të lartë të spektrit, që do të thotë humbje e cilësisë.

Këto 38 programe shiten nga DIGITALB në 3 paketa me pagesë prej 7-20 eurosh për muaj plus dekoderi (CONNAX system). Numri i pajtimtarëve nuk dihet, megjithatë është më i lartë se 100 000 familje (dekoderë – kjo nuk do të thotë 1 dekoder për 1 familje) dhe mund të jetë gjysma e të gjitha familjeve. Në mënyrë që dekoderët të përdoren për televizionin digjital pa abonim, ata duhet të ç'kodohen.

Programet e DIGITALB-it (38 programe, 4 multiplekse), nga të cilat 15 prodhohen dhe redaktohen nga Digitalb) shiten nga distributorë komercialë nëpërmjet abonimit.

DIGITALB gjithashtu transmeton 16 kanale televizive mobile personale (DVB-H norm) në frekuencë analoge (kanali 38 UHF), e cila mund të merret nga telefoni celular (marka: LG, modeli: KU 950), dhe shitet nga Digitalb për 350 Euro.

Prandaj DIGITALB është një ndër aktorët e parë në transmetimin digjital në Shqipëri, sa i përket veprimtarisë së tij, si dhe detajet, mban një pozitë të pamohueshme në procesin e kalimit në transmetimet digjitale në Shqipëri. Shumica e frekuencave të zëna nga Digitalb pa asnjë licencë nuk janë pjesë e Planit të Frekuencave Digitalb Shqiptare sipas marrëveshjes GE06.

2. TRING

Në sistemin numerik tokësor TRING ka ndërtuar një rrjet fiks, për të cilin përdor:

- Kanalin 59 UHF (Fushë Dajt), bazuar në Lejen e Përkohshme për eksperimentimin e transmetimeve Numerike, të dhënë nga KKRT, të cilës i ka skaduar vlefshmëria.

Kanali 59 UHF bën pjesë në Planin Kombëtar të Frekuencave Numerike.

- Kanalin 47 UHF (Fushë Dajt) i cili i është akorduar Dardan TV për transmetime analoge, në bazë të licencës përkatëse, lëshuar nga KKRT. Kanali 47 UHF nuk bën pjesë në planin kombëtar të frekuencave numerike.

Shënim: TRING tashmë është licencuar edhe si operator satelitor. Në këtë sistem ai ripërsërit një numër kanalesh që transmetohen në mënyrë tokësore

3. SHIJAK TV

Në sistemin numerik tokësor Shijak ka ndërtuar një rrjet fiks, për të cilin përdor:

- Kanalin 24 UHF. KKRT ka lëshuar një leje të përkohshme për eksperimentimin e transmetimeve numerike, për të shfrytëzuar kanalin 44 nga qyteti i Tiranës, të cilës i ka skaduar vlefshmëria. Kanali 24 UHF nuk bën pjesë në planin kombëtar të frekuencave numerike, ndërsa kanali 44 UHF bën pjesë në këtë plan.

Konkluzione:

Siç është paraqitur më sipër, situata e transmetimeve numerike tokësore është krejtësisht e parregulluar dhe për pasojë e pa kontrolluar. Operatorët e transmetimeve numerike tokësore, përfshirë operatorët me shtrirje të konsiderueshme në territorin e Shqipërisë, si Digitalb-i, operojnë pa licencat përkatëse që përcaktojnë rregullat dhe kushtet e shërbimit, si dhe detyrimet përkatëse financiare duke shtrembëruar tregun në dëm të operatorëve analogë të licencuar rregullisht.

1.4 Shërbimet e televizionit kabllor

Kohët e fundit ka marrë zhvillim ndërtimi i rrjeteve kabllorë për ofrimin e programeve televizivë. Aktualisht janë 64 operatorë që kanë ndërtuar rrjetet e tyre kabllorë në qendrat kryesore të banuara dhe në një numër komunash të vendit. Rrjetet kabllorë në përgjithësi mbështeten në teknologjinë e vjetruar analoge (duke përdorur kablllo koaksialë) dhe prandaj kanë një kapacitet të kufizuar. Në disa qytete të mëdha janë ndërtuar edhe rrjete me fibra optike.

Operatorët e televizioneve kabllorë në Shqipëri i ofrojnë shërbime disa dhjetëra mijë konsumatorëve. Tarifa mujore e cila i paguhet këtyre operatorëve është rreth 500 -700 Lek, që është tarifë më e ulët se ato të aplikuara nga operatorët të cilët aplikojnë sistemet DVB-T dhe DVB-S.

Me kusht që të njoftohet AKEP-i, këta operatorë tani kanë të drejtë të ofrojnë akses në internet me brez të gjerë dhe ka disa prej tyre që ofrojnë këtë shërbim. Në shumicën e rasteve, investime të tjera janë të nevojshme për operatorët kabllorë në mënyrë që të ofrojnë akses në internet me brez të gjerë.

1.5 Radio tokësore

1.5.1 Radio publike tokësore

Rrjeti publik tokësor administrohet nga kompania RTSH (Radio-Televizioni Shqiptar).

Radio publike përfshin:

- 2 rrjete radio kombëtare: Radio Tirana 1, Radio Tirana 2

- 3 rrjete radio rajonale: Radio Gjirokastra, Radio Korça dhe Radio Shkodra,

Radio Tirana transmeton dy programe radiofonike në shkallë vendi, si edhe një program të tretë në gjuhën shqipe për shqiptarët që jetojnë jashtë vendit. Radio Tirana transmeton në valë të mesme dhe të shkurtra.

Rrjeti i transmetuesve radiofonikë analogë FM mbulon pjesën më të madhe të vendit (mbi 85 %).

Dy pika të fuqishme transmetuese me valë të shkurtra dhe të mesme përdoren për transmetimet radiofonike analoge AM jashtë shtetit.

1.5.2 Radio tokësore private

- 2 radio kombëtare (Top Albania Radio and Radio 2+)

- 53 radio lokale të shpërndara mbi gjithë territorin e Shqipërisë, kryesisht në zonat më shumë të populluara (Ultësira perëndimore, rajoni i Elbasanit, rajoni i Korçës, rajoni i Shkodrës, etj).

SHTOJCA 2

LISTA E SHKURTIMEVE

KM	Këshilli i Ministrave,
MITIK	Ministria e Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit,
MPPT	Ministria e Punëve, Publike dhe Transportit,
MF	Ministria e Financës,
AK	Autoriteti i Konkurrencës,
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
BE	Bashkimi European,
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit,
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë (World Trade Organization),
GATS	Marrëveshja e Përgjithshme e Tregtisë së Shërbimeve,
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve, Elektronike dhe Postare,
BEREC	Organi i Rregullatorëve Evropianë të Komunikimeve Elektronike ,
Ligji 9918	Ligji për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë,

Ligji 8410	Ligji për “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”,
e-SEE	Iniciativa e Europës juglindore “Evropa Juglindore elektronike”,
bSEE	Iniciativa e Europës juglindore “broadband South Eastern Evrope“ ,
AMC	Albanian Mobile Communication ,
GSM	Global System for Mobile communications,
GPRS	Global Packet data for Radio Service,
EDGE	Enhanced Data Rates for GSM evolution,
xDSL	Teknologjitë Digital Subscriber Line,
ADSL	Asymmetric Digital Subscriber Line,
KKRT	Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit,
FNT	Fuqi e Ndjeshme në Treg.
WiMax	Worldwide Interoperability for Microwave Access,
IPRs	Intellectual Property Rights,
Kb/s	Kilo bite për sekondë,
Mb/s	Mega bite për sekondë,
DSL	Digital Subscriber Line,
UMTS	Universal Mobile Terrestrial System ,
3G	Gjenerata e tretë e telefonisë së lëvizshme,
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit,
PKRF	Plani kombëtar i radio frekuencave ,
ECA	Evropean Common Allocation Table,
MPPTT	Ministria e Punëve, Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,
ITU	Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve,
LTE	Long Term Evolution,
PKF	Plani kombëtar i frekuencave,
MHz	Mega Herts,
GHz	Giga Herts,
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar,
GE06	Marrëveshja e Gjenevës 2006,
UHF	Ultra high frequency.

SHTOJCA 3 FUSHËVEPRIMI AKTUAL I SHËRBIMIT UNIVERSAL

Shteti duhet të sigurojë që shërbimet e mëposhtme të jenë të disponueshme për të gjithë përdoruesit fundorë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme.

1. Lidhje në rrjet publik telefonik dhe akses në shërbime publike telefonike në vendndodhje fikse. Lidhja e ofruar duhet të mundësojë përdoruesve fundorë të bëjnë dhe marrin telefonata lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, komunikime nëpërmjet faksit dhe komunikim të të dhënave me shpejtësi të mjaftueshme për funksionimin e aksesit të internetit, duke marrë parasysh teknologjitë aktuale të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe mundësitë që ofron teknologjia.

2. Të ketë të paktën një numëror gjithëpërfshirës të disponueshëm për përdoruesit fundorë në formë e cila është miratuar nga autoritetet përkatëse, në formë elektronike ose e shtypur, ose të dyja, dhe e përditësuar rregullisht, të paktën një herë në vit; së paku një numëror telefonik gjithëpërfshirës të shërbimit të informacionit (*enquiry service*) të disponueshëm për të gjithë përdoruesit fundorë, duke përfshirë përdoruesit e telefonave publikë me pagesë.

3. Telefonat publikë me pagesë të plotësojnë nevojat e arsyeshme të përdoruesve fundorë në kushte të mbulimit gjeografik, numrit të telefonit, akses te këta telefona për përdoruesit me aftësi të kufizuara dhe cilësi të shërbimeve. Të jetë e mundur të bëhen thirrje të emergjencës nga telefonat

publikë me pagesë duke përdorur numrin e vetëm European të emergjencës “112” dhe numra të tjerë kombëtarë të emergjencës, të gjitha pa pagesë (duke mos pasur nevojë të përdoret asnjë lloj pagese).

4. Duhet të merren masa të posaçme për përdoruesit me aftësi të kufizuara për të siguruar akses dhe përballueshmëri të shërbimeve të disponueshme publike telefonike, duke përfshirë akses në shërbimet e emergjencës, shërbimet e drejtorisë së kërkimit të të dhënave, e njëjta si ato që ofrohen për përdoruesit e tjerë fundorë.

5. Masa të posaçme, në këndvështrimin e kushteve në vend, për të siguruar që përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë nga zgjedhja e sipërmarrësve dhe ofruesve të diponueshëm të shërbimeve për shumicën e përdoruesve fundorë.

**Dokumenti i politikave për komunikimet elektronike
në Republikën e Shqipërisë
Lista e planveprimeve për vitin 2010-2011.**

Plan –veprimet këtu rrjedhin nga dokumenti i politikave për komunikimet elektronike, në veçanti nga pikat e paraqitura në tabelat e mëposhtme.

Të përgjithshme

Page	Pikat e dokumentit të politikave
18	Këshilli i Ministrave pret që procedurat dhe formalitetet e nevojshme për të bartur një numër të jenë të sa më të shkurtra dhe sa më të thjeshta. Implementimi i portabilitetit të numrit tashmë është vonuar dhe operatorët duhet të procedojë me implementimin e portabilitetit sipas rregulloreve të nxjerra nga AKEP-i pa vonesë.
18	Këshilli i Ministrave ka për qëllim të rishikojë politikat lidhur me tarifat për spektrin (taksat), lidhur me nivelin e taksave dhe përgjegjësinë për arkëtimin e tyre.
18	Këshilli i Ministrave veçanërisht mirëpret qëllimet e AKEP-it – siç është theksuar në raportin e parë vjetor – për të konsoliduar organizimin e AKEP-it për mbrojtjen e konsumatorëve dhe informacionit si dhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve.
19	Një studim i gjerë do të jetë i nevojshëm për këtë qëllim gjatë vitit 2010 me qëllim të bërjes së rekomandimeve për çdo ndryshim të nevojshëm në ligj . Kjo do të marrë parasysh se sa mund të qëndrojë mbrojtja që mundësohet nga ligji 8410 për sa i përket përmbajtjes së transmetimit tradicional.
20	Deri në një situatë kur kushtet të jenë gati, problemet praktike mund të shmangen duke përmirësuar bashkëpunimin mes KKRT-së dhe AKEP-it me një memorandum zyrtar të mirëkuptimit për çështje lidhur me menaxhimin e spektrit të radios duke përfshirë mbikëqyrjen e aspekteve teknike, si dhe më vonë duke bërë një kalim të kompetencave teknike për frekuencat nga KKRT tek AKEP , por jo përmbajtjen.
20	Këshilli i Ministrave ka për qëllim të sigurojë se ligji për transmetimet radiotelevizive e ndjek ritmin e zhvillimeve teknologjike si dhe legjisllacionin e BE.
21	Këshilli i Ministrave ka për qëllim të zhvillojë një konsultim të gjerë për gjetjen e përgjigjeve të duhura lidhur me zgjerimin e hapësirës për krim dhe keqbërje, siç janë mashtrimet <i>on-line</i> , abuzimi i të miturit, spam etj.
22	Rritja e penetrimit të shërbimeve me brez të gjerë është një nga objektivat kryesore të Këshillit të Ministrave Politika dhe Këshilli i Ministrave është që të lejohet dhe inkurajohet përdorimi i çdo teknologjie ,e cila do të sjellë një gamë më të gjerë të zgjedhjes, cilësi dhe çmime më të mira në treg.

Numër	Veprimi	Agjencia përgjegjëse	Partnerë të tjerë	Afatet kohore
A1	Të implementohet portabiliteti i numrit për rrjetet fikse dhe të lëvizshme pa vonesa të tjera	AKEP	Operatorët	Nentor 2010
A1	Të garantohet se roli i AKEP për mbrojtjen e konsumatorit është i bashkërenduar me regjimin e gjerë për mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri	AKEP	MITIK, Ministrinë e tjera të interesuara	Korrik 2010
A1	Të zhvillohet një studim në vitin 2010 për pasojat që konvergjenca teknologjike mund ti ketë në organizimin e masave rregullatore.	MITIK	AKEP, KKRT, AKSHI	Shtator 2010
A1	Rishikimi i nevojës për bashkëpunim më të afërt ndërmjet rregullatorëve për shkak të konvergencës ndërmjet komunikimeve private dhe të transmetimeve radiotelevizive.	MITIK	AKEP, KKRT	Shtator 2010

Spektri

Faqe	Pikat në dokumentin e politikave
27	Vënia në dispozicion e disa brezave të cilët aktualisht janë të zënë nga përdorues të qeverisë është e rëndësishme. Është e rëndësishme të mos vendosen kosto të larta për përdorimin ekonomik të frekuencave. Këto kosto duhet të jenë të drejta dhe në përputhje me të ardhurat potenciale nga përdorimi i tyre. Parimi i tarifave të drejta për përdorimin e frekuencave është fundamental për të quajturën “ekonomi wireless”.
18	Këshilli i Ministrave është në dijeni të çështjeve lidhur me taksat për spektrin dhe ka për qëllim ta rishikojë këtë politikë si lidhur me nivelin e taksave ashtu edhe lidhur me përgjegjësinë për arkëtimin e tyre.
28	Duhet bërë përpjekje që disa breza të jenë neutralë ndaj teknologjisë, p.sh. 900MHz, 1.8GHz, 2.6GHz dhe 3.5GHz. Bazuar në përvojën në vendet e tjera dhe në efektshmërinë e pajisjeve moderne, duhet konsideruar ndryshimi i brezave 900MHz dhe 1800 MHz në mënyrë që të lejohet përdorimi i teknologjive më të reja (UMTS, LTE) të cilat kërkojnë blloqe prej 5MHz në vend të kanaleve prej 200MHz të përdorur aktualisht për GSM.

Numri	Veprimi	Agjencia përgjegjëse	Partnerët etjerë	Afatet kohore
B1	Identifikimi i brezave të Qeverisë të cilët mund të lirohen si dhe negociohet lejimi për ri-përdorimin e tyre.	MITIK	AKEP, KKRT	Prill 2010
B2	Amendimet e rregulloreve për pagesat për spektrin dhe tarifën e qeverisë për spektrin	AKEP	MITIK, MF, KM	Qershor 2010
B3	Zhvillimi i një këshillimi publik për vënien e brezave 2.1 dhe 2.6 GHz në dispozicion mbi parimin e paanësisë teknologjike	AKEP	MITIK	Maj 2010
B4	Vënia e brezave 3.4 deri 3.8 GHz në dispozicion mbi parimin e paanësisë teknologjike (e njohur për teknologjinë e aksesit në telefoninë fikse pa tel, wireless).	AKEP	MITIK	Gjysma e dyte 2010
B5	Harmonizimi periodik i PKRF me Tabelën Europiane të Ndarjes së Frekuencave	MITIK	AKEP, KKRT	Shtator 2010
B6	Të përgatitet strategjia dhe objektivat e televizionit digjital	KKRT	MITIK	Shtator 2010
B7	Të përgatitet një memorandum i mirëkuptimit ndërmjet KKRT-së dhe AKEP-it për bashkërendimin e veprimtarive të administrimit të spektrit, përfshirë monitorimin	MITIK	AKEP dhe KKRT	Qershor 2010

Shërbimi Universal dhe të drejtat e përdoruesve

Faqe	Pikat e dokumentit të politikave
31	Këshilli i Ministrave mirëpret këto qëllime dhe pret që ministria, AKEP-i dhe agjencitë e tjera të interesuara të mbajnë këtë çështje në rishikim të vazhdueshëm për të siguruar përfitime maksimale për përdoruesit në Shqipëri.
29	Sipas ligjit 9918, AKEP ka për detyrë të caktojë një ose më shumë ofrues të shërbimit universal, megjithëse sipas ligjit të BE-së duhet të ndërmarrin këtë masë nëse është e domosdoshme, dmth nëse paketa e shërbimeve bazë nuk ofrohet në një mënyrë tjetër. Aksesit në vendndodhje fikse mund të ofrohet duke përdorur teknologjinë e lëvizshme dhe mund të ketë ofrues të ndryshëm të shërbimit universal në pjesë të ndryshme të vendit ose për shërbime të ndryshme të paketës bazë.

Numri	Veprimi	Agjencia përgjegjëse	Partnerët e tjerë	Afatet kohore
C1	Të rishikohet përvoja në vendet e tjera të BE-së në sigurimin shërbimit universal në zonat rurale.	AKEP		Gjashtë muji dyte 2010
C2	Të propozohen mënyra, të cilat janë në përputhje me ligjin shqiptar dhe <i>acquis</i> të BE, për të promovuar aksesin në zonat rurale.	MITIK	AKSHI, AKEP	Qershor 2010
C3	Bashkërendimi i strategjisë dhe objektivave për kapacitetin e Internet me brez të gjerë të disponueshëm në Shqipëri. Studimi i fizibilitetit për broadband/backbone kombëtar.	MITIK	AKSHI, AKEP	Qershor 2010
C4	Të rishikohet dhe analizohet disponueshmëria e elementeve të shërbimit universal në Shqipëri dhe të zhvillohet një pozicion i duhur lidhur me politikën bazuar në këshillimet e zhvilluara.	AKEP	Operatorët	Nëse kërkohet
C5	Infrastruktura kurrizore brezgjere kombëtare (National Broadband/Backbone): Zgjerimi i aksesit brezgjere për mbulim 100% të territorit të Republikës së Shqipërisë: Partneritet Publik Privat dhe asistencën teknike gjatë zbatimit të projektit për dy vjet .	MITIK	KM, AKEP, dhe të gjitha institucione qendrore/lokale dhe partnerë ndërkombëtarë	Qershor 2010- Dhjetor 2011.

C6	Biblioteka Kombëtare Digjitale: përgatitja e konceptit, zhvillimit të strategjisë dhe modelit të biznesit	MITIK	AKSHI, MASH, Biblioteka Kombëtare si dhe partnerë lokale/ndërkombëtar	Gjysma dyte e 2010.
C7	m- <i>banking</i> , rritja e mundësive për transaksione nga aparatet celular përgatitja e nismave të Këshillit të Ministrave si dhe e konceptit dhe modelit të biznesit.	MITIK	AKEP, Operatorët mobile, Bankat.	Shtator 2010

Subvencionet dhe rregullat e konkurrencës

Faqe	Pikat e dokumentit të politikave
31	Këshilli i Ministrave beson se efektet e liberalizimit që sjell ligji 9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” do të ndikojnë pozitivisht, si dhe do të vërejë deri në çfarë mase hyrësit e rinj në treg dhe investimet private rriten me mundësitë e reja të disponueshme dhe ato të cilat do të bëhen të disponueshme pasi brezat e rinj të spektrit të jenë ofruar në treg.
32	Ndërkohë, Këshilli i Ministrave e agjencitë përkatëse do të këshillohen me bizneset lidhur me nevojën për të zgjeruar incentivat e taksave për investime të cilat ofrojnë akses me brez të gjerë.
32	Marrjen parasysh të mundësisë së përdorimit të fondeve publike për ofrimin e investimeve pas 2010, Këshilli i Ministrave do të këshillohet gjërësisht dhe do të sigurojë që çdo skemë i zbaton udhëzimet e BE-së.

Numri	Veprimi	Agjencia përgjegjëse	Partnerët e tjerë	Afatet kohore
D1	Këshillimi me industrinë mbi kërkesën për krijimin e lehtësirave fiskale për investime në sistemin e aksesit në Internet me brez të gjerë.	MITIK	AKEP, AK	Gjysma e dyte 2010
D2	Duhet të bëhet më shumë punë në zonat e pazhvilluara në shkolla dhe universitete në mënyrë që të inkurajohen studentët drejt përdorimit të Internetit për kërkimin e materialit shkollor (kjo duhet kërkuar nga çdo mësimdhënës për lëndën përkatëse). Kërkohet bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit në këtë fushë. Bashkitë ose komunat duhet të organizojnë konferenca (duke përdorur fondet e tyre) me mbështetjen e ekspertëve të këtij sektori të cilët do ti shpjegojnë potencialin e Internetit me brez të gjerë popullsisë së rajonit.	AKSHI	MASH, Autoritetet Vendore	Gjysma e dyte 2010

Aksesi në pronë publike dhe private

Faqe	Pikat e dokumentit të politikave
33	Këshilli i Ministrave e konsideron se është e detyruar të bëjë çfarëdo ndryshime të jetë e nevojshme në ligje dhe rregullore të cilat qeverisin përdorimin e pronës publike dhe private për të siguruar që pengesat për zhvillimin e tregut janë zvogëluar.
33	Prandaj, Këshilli i Ministrave propozon të bëjë një studim të situatës në këshillim me AKEP-in, industrinë, ministrinë përkatëse dhe palë të tjera të interesuara për të vendosur çfarë masa mund të jenë të nevojshme për të rregulluar situatën.

Numri	Veprimi	Agjencia përgjegjëse	Partnerët e tjerë	Afatet kohore
E1	Grupi i punës i ngritur nga Ministri i Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të përgatisë dhe analizojë problemet praktike të cilat operatorët i kanë hasur, siç janë pengesat e shfaqura gjatë aksesit në pronë publike dhe private	MITIK	Anëtarët e grupit të punës	Qershor 2010
E2	Analiza e përvoja ndërkombëtare mbi mënyrat për të zgjidhur problemin.	MITIK	Anëtarët e grupit të punës	Maj 2010
E3	Përgatitja e një analize të pozicionit ligjor lidhur me problemet e identifikuara dhe masat e propozuara rregullatore, duke përfshirë për shembull, amendimin e rregullave të ndërtimit për të garantuar që ndërtesat e reja janë të dizajnuara dhe pajisura në mënyrën e duhur.	MITIK	Anëtarët e grupit të punës	Maj 2010
E4	Përfundimi i akteve ligjore dhe nënligjore për të Drejtën e Kalimit (Rights of Way)	MITIK	Konsulenca lokale ose ndërkombëtare	Qershor- Korrik 2010
E5	Përpilimi i propozimeve për masat për të inkurajuar investimet në infrastrukturën nëntokësore për komunikimet elektronike	MITIK	Autoritetet vendore, MPPT, MF	Shtator 2010

Monitorimi dhe informimi i tregut

Faqe	Pikat e dokumentit të politikave
34	Qëllimet e Këshillit të Ministrave janë projektimi i veprimeve të tyre në këtë fushë mbi faktet e tregut, siç ato shfaqen duke përfshirë efikasitetin e dukshëm regjimit të ri rregullator në arritjen e qëllimeve.
34	<p>Këshilli i Ministrave pret që ministria dhe AKEP-i:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të publikojnë raporte të herë pas hershme me interes publik mbi gjendjen e tregut dhe zhvillimit të tij. • Të bashkëpunojë në organizimin e konferencave publike vjetore për të interesuarit në komunikime elektronike.

Numri	Veprimi	Agjencia përgjegjëse	Partnerët tjerë	Afatet kohore
F1	Ngritja e mënyrave nëpërmjet cilave konsumatorët do të mund ti krahasonin tarifatat me pakicë të celularëve	AKEP	Operatorët mobile, Organizatat e Konsumatorëve.	Tremujori i katert i 2010
F2	Themelimi i atlasit elektronik të Shqipërisë i cili paraqet aksesin brezëgjërë në nivel kombëtar.	AKEP	AKSHI	2011
F3	Të përgatitet, ose të bashkëpunojë me ministrinë në përgatitjen raporteve të rregullta për situatën e tregut të shërbimeve elektronike dhe zhvillimin e tij.	AKEP	MITIK, AKSHI	Nëntor 2010
F4	Të organizohet një konferencë publike vjetore (në nëntor) për të interesuarit në tregun shqiptar të komunikimeve elektronike, në bashkëpunim me Ministrinë dhe organet e tjera shtetërore të këtij sektori.	AKEP	MITIK, AKSHI, KKRT	Nëntor 2010

Integrimi European

Faqe	Pikat e dokumentit të politikave
35	Këshilli i Ministrave ka vendosur që në rastin e parë të mundshëm, të transpozojë ndryshimet e vitit 2009 në <i>acquis</i> të BE-së për komunikimet elektronike në ligjin shqiptar
36	Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në bashkëpunim me AKEP-in, AKSHI-n dhe agjencitë e tjera qeveritare, do të ndjekë evoluimin e politikave të BE-së për Shoqërinë e Informacionit, nëpërmjet publikimit të seancave të komisioneve dhe grupeve përkatëse europiane në fushën e Shoqërisë së Informacionit dhe Komunikimit si dhe rezultateve të publikuara të studimeve. (Për referim: “Strategjia ndërsektorale e shoqërisë së informacionit”). Para se Shqipëria të fitojë statusin vëzhgues për komisionet dhe grupet kjo do të thotë të punohet nga materialet e publikuara nga burimet zyrtare të BE-së ose me materialet e publikuara nga shërbime raportuese komerciale – për të cilat kërkohet abonimi.

Numri	Veprimi	Agjencia përgjegjëse	Partnerët e tjerë	Afatet kohore
G1	AKEP ti ofrojë inpute MITIK-ës lidhur me zbatimin e kuadrit rregullator të BE-së	AKEP	MITIK	Në vazhdimësi
G2	Në bashkëpunim me Komisionin European të ndiqen mbledhjet e rëndësishme	MITIK	AKEP	Në vazhdimësi
G3	Të bëhen ndryshimet në ligjin ekzistues si përgjigje ndaj përvojave praktike të ligjit aktual dhe ndaj ndryshimeve të vitit 2009 të kuadrit rregullator të BE-së.	MITIK	AKEP, AKSHI, KKRT, KUVENDI I R SH.	Gjysma e dytë e vitit 2010
G4	Përfundimi i amendimeve të ligjit 8410 për të përditësuar referencat për ligjin e mëparshëm për telekomunikacionet dhe për të garantuar se është në përputhje me ligjin 9918.	MITIK	AKEP, KKRT, KUVENDI I R SH.	Gjysma e dytë e vitit 2010

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 31.5.2010

Doli nga shtypi më 31.5.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 44 lekë